



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 473 Akti

Nr. 424 Vendimi  
Tiranë, më 15.7.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Genta Tafa (Bungo)** Kryesuese  
**Alma Faskaj** Relatore  
**Lulzim Hamitaj** Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 13.7.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim, në seancën dëgjimore publike, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI TË RIVLERËSIMIT:** **Z. Isa Jata, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për dësa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;**

**Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;**

**Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”;**

**Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, i ndryshuar.**

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Isa Jata, duke krahasuar “Deklaratën e pasurisë të rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jo bankar etj., të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, z. Isa Jata:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\*, datë 27.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2021, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Isa Jata.

5. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, të trupit gjykues nr. 4, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

7. Në datën 15.4.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, po në këtë datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

**8.** Në datën 21.6.2021 trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Isa Jata, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

**9.** Në datën 21.6.2021 trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, për t' u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë pretendime/sqarime shtesë, brenda datës 7.7.2021.

**10.** Në datën 25.6.2021 subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes dhe më 7.7.2021 dërgoi shpjegimet mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

**11.** Në datën 8.7.2021 trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Isa Jata, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 13.7.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

**12.** Në datën 13.7.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**13.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Isa Jata, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

**14.** Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

**15.** Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, kërkoi konfirmimin në detyrë.

**16.** Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Isa Jata. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 13.7.2021, për të rifilluar më 15.7.2021, për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**17.** Z. Isa Jata ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur dhe dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**18.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**19.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**19.1** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**19.2** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**19.3** Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**19.4** Por, referuar vendimit nr. 2/20171, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**19.5** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shpresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komisioni; (d) provat shpresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. RIVLERËSIMI I PASURISË**

**20.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit, si dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

**21.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, të paraqitur më parë tek ky institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Isa Jata.

**22.** Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

**23.** Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni, është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2010 - 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; si dhe (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

**24.** Subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur), në datën 27.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar edhe nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

25. Në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, e dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja V. J., kanë deklaruar:

**1. Apartament banimi 2+1, ndodhur në rrugën “\*\*\*”, pallati \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Tiranë.** Vlera e apartamentit: 1,245,128 lekë, e shlyer plotësisht deri në vitin 2005. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie *kredi nga Enti Kombëtar i Banesave Tiranë së bashku me bashkëshorten V. J., sipas kontratës së shitblerjes datë 26.3.2005.*

### **Hetimi<sup>1</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

**1.1** Subjekti e ka deklaruar për herë të parë pasurinë në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, në të cilën ka deklaruar: *“Apartament banimi 2+1, me vendndodhje: rr. ‘\*\*\*’, Blloku \*\*\*, p. \*\*\*, ap\*\*\*, Tiranë. Vlera: 1,214,000 lekë. Burimi: me kredi të Entit Kombëtar të Banesave Tiranë, nr. 209. Vlera e mbetur pa shlyer: 766,000 lekë”.*

Në DIPP-në të vitit 2004 subjekti ka deklaruar vlerën e mbetur të pashlyer të kredisë ndaj Entit Kombëtar të Banesave: *“Kredi për strehim, shuma 1,214 milion lekë, në vitin 1995. Kontratë provizore me Entin Kombëtar i Banesave. Shuma e detyrimit financiar të shlyer gjatë vitit 2004: 0.0432 milion lekë. Shuma e detyrimit të pashlyer deri në datën 31.12.2004: 0,7228 milion lekë”,* Ndërsa, në DIPP-në të vitit 2005 ka deklaruar: *“Apartament banimi 2+1, rr. ‘\*\*\*’, p. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Kredi nga Enti i Banesave Tiranë. Shuma e shlyer: 345,500 lekë, me mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 8.3.2005. Likuiduar kredia dhe e hipotekuar me nr. \*\*\*, datë 28.4.2005”.*

Trupi gjykues konstatoi mospërputhje në deklarimin e vlerës së apartamentit midis deklaratës *Vetting*, me vlerë 1,245,128 lekë, me deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, me vlerë 1,214,000 lekë.

**1.2** Nga hetimi i Komisionit për pasuritë e deklaruara nga subjekti rezultoi se kjo pasuri është vendosur si garanci hipotekore për kredinë e marrë në “Credins Bank” nga subjekti, në vlerën 15,000 euro, me qëllim shlyerjen e një pjesë të çmimit të blerjes për pasurinë apartament në G. (i analizuar në vijim).

ASHK-ja<sup>2</sup> konfirmon se në emër të shtetasve Isa R. Jata dhe V. J. J. figuron e regjistruar pasuria apartament, me sip. 68.1 m<sup>2</sup>, z. k\*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, bashkëlidhur kartela e pasurisë nr. \*\*\*, nga e cila konstatohet se prona është e regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortes dhe është fituar me kontratë shitjeje me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave, me vlerë të paguar 1,245,128 lekë. Në seksionin “E” të kartelës “bllokime mbi pasurinë” konstatohet se në datën 31.1.2020 është vendosur barrë hipotekore në favor të Drejtorisë Rajonale Tatimore, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 24.12.2019. Nga hetimi i dokumenteve të përcjella në Komision nga institucionet, rezulton se ky bllokim lidhet me detyrimet e prapambetura të bashkëshortes së subjektit për aktivitetin e saj avokati me Drejtorinë Rajonale Tatimore. Bashkëlidhur shkresa e ASHK-së dhe dokumentacioni nga arkiva fizike lidhur me këtë pasuri, ku gjendet kontrata e shitjes së apartamentit me nr. \*\*\*, datë 26.3.2005, me palë shitëse Entin Kombëtar të Banesave dhe palë blerëse shtetasit Isa Jata dhe V. J., me objekt shitjen e apartamentit me sipërfaqe shfrytëzimi 61.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me vlerë

<sup>1</sup>Subjekti rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* tij për pasurinë apartament banimi dokumentacioni si vijon: (a) shkresë kthim përgjigje, datë 31.10.2016, ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë dhe kartela e pasurisë nr. \*\*\*, për pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 68.10 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Tiranë, regjistruar në datën 31.10.2013, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe shtetas V. J.; (b) kontratë shitje apartamenti nr. \*\*\*, datë 26.3.2005, lidhur ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe blerëse, subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja V. J., për apartamentin të ndodhur në Bllokun \*\*\*, Tiranë, me sipërfaqe ndërtimi 91.8 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe shfrytëzimi 61.8 m<sup>2</sup>; (c) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 1.6.2015, të nënshkruar nga shtetasit B. T. dhe H. C., si përfaqësues të “Credins Bank”, të cilët deklarojnë se japin pëlqimin për lirim nga bllokimet e regjistruara në favor të kësaj banke të pasurisë nr. \*\*\*, të regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, e cila është bllokuar në favor të “Credins Bank”, në bazë të kontratës së hipotekimit nr. \*\*\*, datë 25.5.2010.

<sup>2</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 17.2.2021, në dosjen e Komisionit.

shitjeje 1,245,128 lekë. Rezulton se nga vlera e apartamentit 1,245,128 lekë është zbritur vlera e punimeve të kryera para vitit 1992 në shumën 31,002 lekë, si dhe vlera e kontributit falas të shtetit në shumën 455,645 lekë. Nga pala blerëse është paguar vlera fillestare prej 90,000 lekësh, këstet deri në mars të vitit 2005 në shumën 400,413 lekë, si dhe detyrimi financiar, referuar kostos së EKB-së, në shumën 268,062 lekë. Subjekti, gjatë hetimit<sup>3</sup>, depozitoi kontratën e shitjes me këste nr. \*\*\*, datë 14.12.2004, me palë shitëse Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Tiranë dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit.

OSHEE-ja<sup>4</sup> konfirmon se identifikohet një abonent me të njëjtat gjeneralitete si subjekti i rivlerësimit, z. Isa R. Jata, i cili rezulton të ketë lidhur kontratë për furnizimin me energji elektrike në datën 1.10.1997, në Tiranë.

UKT-ja<sup>5</sup> konfirmon se rezulton një kontratë e lidhur me shtetasin Isa R. Jata, me adresë: rruga “\*\*\*”, Tiranë.

**1.3** Në lidhje me çmimin e shitjes dhe burimin e krijimit të pasurisë apartament, referuar kontratës së shitjes të lidhur me Entin Kombëtar të Banesave, rezulton se vlera e shitjes së apartamentit është 1,245,128 lekë, mbi të cilin janë bërë zbritje nga pala shitëse, përkatësisht për vlerën e punimeve deri në vitin 1992, në shumën 31,002 lekë dhe kontributi falas nga shteti, në shumën 455,645 lekë. Në kontratë citohet se vlera e paguar nga subjekti me këste deri në mars të vitit 2005 është 400,413 lekë dhe vlera e paguar nga pala blerëse për vlerën e mbetur është shlyer në datën 8.3.2005, pak ditë para nënshkrimit të kontratës, në vlerën 268,068 lekë. Gjithashtu, subjekti ka përcjellë gjatë hetimit<sup>6</sup> kontratën e shitjes me këste nr. \*\*\*, datë 14.12.2004, në të cilën përshkruhet se në datën 27.2.1995 subjekti ka shlyer vlerën prej 90,000 lekësh dhe deri në datën e nënshkrimit të saj është shlyer me këste vlera 396,813 lekë. Pagesat e kësteve të kredisë ndaj EKB-së janë bërë *cash* dhe në mënyrë periodike (kryesisht çdo muaj), duke filluar nga viti 1995 deri në mars të vitit 2005. Komisioni nuk ka evidenca të pagesave të kryera nga subjekti i rivlerësimit sipas periudhave përkatëse, të cilat të përdoren për efekt të analizës financiare. Megjithatë, në analizën e hartuar nga Komisioni janë konsideruar vlerat e përshkruara në kontratën e shitjes me këste nr. \*\*\*, datë 14.12.2004, me palë shitëse Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave, Tiranë dhe kontratën e shitjes nr\*\*\*, datë 26.3.2005, lidhur ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe palë blerëse Isa Jata dhe V.J. .

**1.4** Komisioni konsideroi me qëllim realizmin e analizës financiare vlerën totale prej 758,481 lekësh të shlyer nga subjekti. Ndërsa, si periudhë shlyerjeje është marrë në konsideratë periudha 1.9.1995 – 26.3.2005, sipas deklarimeve periodike vjetore, si dhe shpjegimeve e deklarimeve në pyetësor<sup>7</sup> të subjektit të rivlerësimit.

**1.5** Komisioni kreu në vijim analizën financiare të paraqitur në tabelën, si më poshtë vijon:

---

<sup>3</sup>Shihni kontratën bashkëlidhur pyetësorit standard, provë e përgjigjes nr. 1.

<sup>4</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 9.12.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>6</sup>Shihni kontratën bashkëlidhur pyetësorit standard, provë e përgjigjes nr. 1.

<sup>7</sup>Shihni pyetësorin standard, përgjigjen nr. 1

(vlerat në lekë)

Periudha	01.09.1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	01.03.2005	01.09.1995 - 01.03.2005
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	80 464	303 006	316 011	409 948	533 625	599 175	955 214	1 468 813	1 301 704	1 530 397	265 053	7 763 409
Paga pranë Postës Shqiptare sha të bashkëshortes	51 913	179 849	145 087	171 110	199 337	18 468	264 000					1 029 764
Shpenzimet jetike	30 888	337 999	300 000	300 000	300 000	540 000	504 660	469 320	375 856	375 856	73 038	3 607 616
Këstet e shlyerjes së apartamentit	90 000	44 090	44 090	44 090	44 090	44 090	44 090	44 090	44 090	44 090	271 668	758 481
Shtesa/pakësime në likuiditetet në bank dhe cash										450 000	869 292	1 319 292
<i>Rezultati financiar</i>	<i>11 489</i>	<i>100 766</i>	<i>117 008</i>	<i>236 968</i>	<i>388 872</i>	<i>33 553</i>	<i>670 464</i>	<i>955 403</i>	<i>881 758</i>	<i>660 451</i>	<i>(948 946)</i>	<i>3 107 784</i>

Sa më sipër, në analizë të harmonizuar të të gjithë provave të administruara, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe në mënyrë të plotë dhe në përputhje me ligjin pasurinë në deklaratën *Vetting*. Nga analiza financiare rezultojnë se subjekti ka pasur burime të ligjshme për të krijuar pasurinë e sipërcituar.

**2. Apartament me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, në G., Kavajë**, ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator B. T. (parcela nr. \*\*\*), në vlerën 30,000 euro, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., të datës 11.5.2010, hartuar përpara noteres M. Sh. . Vlera e apartamentit: 30,000 euro, shlyer plotësisht. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti ka deklaruar si burim të krijimit për likuidimin e saj, veç kursimeve, marrë edhe kredi afatmesme prej 15,000 euro në “Credins Bank”, Tiranë.

Subjekti ka sqaruar në deklaratën *Vetting*, në lidhje me këtë pasuri: *“Pavarësisht se sipas deklaratës noteriale, apartamenti është blerë nga shtetasi A. D., faktikisht, për shkak të mospasjes të një kontrate shitblerjeje ndërmjet këtij të fundit dhe investitorit, shoqërisë ‘\*\*\*\*’sh.p.k., nga ana ime është hartuar edhe një kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, përpara noteres M. Sh. . Siç thuhet në deklaratë, kontrata është përpiluar vetëm për arsye të pamundësisë së lidhjes së një kontrate shitjeje përfundimtare, sepse apartamenti është i pahipotekuar. Tashmë ky apartament është në proces legalizimi (shihni vërtetimin nr. \*\*\*, datë 25.1.2017, të ALUIZNI-t)”*.

### Hetimi<sup>8</sup>/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

**2.1** Subjekti e ka deklaruar për herë të parë pasurinë në DIPP-në e vitit 2010: *“Blerë apartament me sip. 53 m<sup>2</sup>, në G., Kavajë, të ndërtuar nga shoqëria ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., me administrator B. T. (parcela nr. \*\*\*) në vlerën 30,000 euro. Blerja është bërë sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*rep., të datës 11.5.2010, hartuar përpara notere M. Sh., në të cilën ka bërë shpjegim sqarues.*

*Pavarësisht se sipas deklaratës noteriale apartamenti nga ana ime i është blerë shtetasit A. D., faktikisht, për shkak të mospasjes së një kontrate shitblerjeje ndërmjet këtij të fundit dhe investitorit, shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., nga ana ime është hartuar edhe një kontratë sipërmarrjeje nr\*\*\*\*, datë 11.5.2010, përpara noteres M. Sh., kontratë e cila nuk më vë përpara ndonjë detyrim, siç thuhet në të, por është përpiluar vetëm për arsye të pamundësisë së lidhjes së një kontrate shitjeje përfundimtare, sepse apartamenti është i pahipotekuar. Vlera: 30,000 euro, shlyer plotësisht vlera*

<sup>8</sup>Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting*: vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, lëshuar nga ALUIZNI, Drejtoria Zonat Turistike, dhe vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, lëshuar nga ALUIZNI, Drejtoria Zonat Turistike; revokim kontratë nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, me investitorë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositës shtetasi A. D.; deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., datë 11.5.2010, e nënshkruar nga shtetasi A.D. dhe Isa Jata; kontratë sipërmarrjeje nr\*\*\*, datë 11.5.2010, nënshkruar ndërmjet investitorit “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositësit Isa Jata; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; kopje të konfirmimit bankar nga “Credins Bank”, me nr\*\*\*prot., datë 28.12.2016.

*e mësipërme prej 30,000 euro. Tashmë është bërë pagesa e plotë. Për likuidimin e saj, veç kursimeve familjare, tërhoqëm një kredi afatmesme prej 15,000 euro pranë 'Credins Bank', Tiranë”.*

### **Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike, ka rezultuar si vijon:**

**2.1.1** ASHK-ja<sup>9</sup>, Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara, konfirmon se shtetasi Isa R. Jata rezulton aplikues pranë Drejtorisë Vendore Zonat e Stimuluara për ndjekjen e procedurave të legalizimit dhe kalimin e pronësisë së truallit në funksion të ndërtimit, me praktikat nr\*\*\*prot., datë 22.4.2015 dhe praktikën nr. \*\*\*prot., datë 20.4.2015. Rezulton se pas verifikimit fizik të dosjeve u konstatua se në të dyja këto aplikime bëhet fjalë për të njëjtin apartament.

**2.1.2** Me shkresën kthim përgjigje të ASHK-së bashkëlidhur përcillet dokumentacioni tekniko-ligjor dhe aktet noteriale të tjetërsimit të kësaj prone, si vijon:

- i. Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, nënshkruar ndërmjet investitorit “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositësit Isa Jata, për apartamentin me sip. 53 m<sup>2</sup>, në godinën nr. 2, kati i 2-të, në fshatin turistik G., kundrejt vlerës 18,550 euro. Kësti i parë në shumën 5.000 euro do të shlyhet brenda datës 15.6.2010, ndërsa këstet e tjera me marrëveshje midis palëve.
- ii. Revokim kontrate nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, me investitorë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositës shtetasi A. D., në të cilën palët bien dakord që të revokojnë kontratën e sipërmarrjes së nënshkruar ndërmjet tyre, me nr. \*\*\*, datë 25.2.2005. Palët në këtë aneks kontrate pranojnë dhe bien dakord që apartamenti nuk do të jetë në katin e tretë të banimit, por do të jetë në katin e dytë të banimit.
- iii. Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., datë 11.5.2010, nënshkruar nga shtetasi A. D. dhe subjekti i rivlerësimit. Sipas deklaratës, shtetasi A. D. ka nënshkruar me kompaninë “\*\*\*\*” sh.p.k. kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 25.2.2005, në të cilën ka prenotuar një apartament me sip. 53 m<sup>2</sup>, në katin e dytë të godinës nr. \*\*\*, në G., kundrejt vlerës 18,550 euro, e cila me aneks kontratën e datës 23.3.2007 është ndryshuar apartamenti, me të njëjtën vlerë, por me një apartament në katin e tretë të objektit. Me aktin nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, janë revokuar kontratat e mësipërme dhe është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe z. Isa Jata. Deklarohet se ky akt është veprim formal/fiktiv, pasi në fakt ky apartament i është shitur z. Isa Jata nga shtetasi A.D. kundrejt shumës 30,000 euro. Ky veprim bëhet për faktin se objekti është i peregjistruar dhe për të qenë më i garantuar z. Isa Jata.
- iv. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, me deklarues shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila deklaron se në datën 11.5.2010 është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka porositur një apartament me sip. 53 m<sup>2</sup>, në godinën nr. 2 ku po ndërton kjo shoqëri, kati i tetë, Kavajë. Vlera e apartamentit është 18,550 euro. Shoqëria, me këtë akt, deklaron se z. Isa Jata ka likuiduar të gjithë shumën për blerjen e këtij apartamenti.
- v. Dokumentacioni i legalizimit: formulari I, nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2015, dhe nr\*\*\*prot., datë 22.4.2015, i ALUIZNI-t; kërkesa për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi truallin e njësisë së ndërtuar, subjekti i interesuar Isa Jata, për njësinë e ndërtuar banesë, me vendndodhje G., me sip. 53 m<sup>2</sup>; mandatpagesat e kryera nga “Credins Bank” për legalizimin e objektit “\*\*\*\*” sh.p.k.; vendimi për kualifikimin e ndërtimit informal nr\*\*\*, datë 19.6.2018, të Agjencisë së Legalizimit, Drejtoria Zonat Turistike, ku vendoset legalizimi informal fiktiv i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; si dhe vendimi nr. \*\*\*, i KRRT-së, komuna G. .

**2.1.3** Komisioni i kërkoi<sup>10</sup> shpjegime subjektit mbi shkakun dhe arsyet e kërkesave drejtuar ALUIZNI-t për legalizimin e këtij objekti apartament banimi, për të cilin ka sqaruar se: “[...]

<sup>9</sup>Shihni shkresën nr\*\*\*prot., datë 31.12.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>10</sup>Shihni pyetëSORIN nr. 2, përgjigjja nr. 1.4.



*kërkesa pranë ALUIZNI-t për këtë apartament është bërë nga ana ime pasi, nga viti 2010 unë jam blerësi de jure dhe de facto i saj. Kam shlyer plotësisht vlerën e apartamentit sipas çmimit të përcaktuar në deklaratën noteriale ndaj shitësit A.D. . Faktin e mospasjes detyrime nga ana ime ndaj investitorit, shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k. e konfirmon përfaqësuesi i shoqërisë E. T. [...] deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, tregon se për këtë pasuri nuk kemi asnjë detyrim ndaj shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k., prandaj edhe aplikimi për regjistrim e këtij apartamenti pranë ALUIZN-it është bërë nga ana ime [...]*”.

Subjekti vijon me shpjegimet<sup>11</sup> e tij në lidhje me moskalimin e pronësisë në emër të tij, se: “[...] ende nuk kemi asnjë përgjigje lidhur me këtë pasuri, ndonëse brenda kompleksit kanë filluar dhe janë pajisur me certifikata...”. Subjekti shton<sup>12</sup> se: “...në vijim, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020, u njoftova mbi detyrimet financiare për objektin ‘\*\*\*’ sh.p.k. me vendndodhje në zonën e stimuluar [...] në datën 7.1.2021, [...] unë nëpërmjet ‘Credins Bank’ bëra edhe pagesat përkatëse dhe i dërgova pranë ASHK-së Tiranë. Tashmë jam në hapat e fundit të përfundimit të procedurës për pajisjen me aktin e pronësisë së apartamentit<sup>13</sup>”.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar në Komision dokumentacionin e regjistrimit të kësaj pasurie në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, si më poshtë vijon:

- i. vendimin nr. \*\*\*, datë 18.2.2021, për legalizimin e ndërtimit pa leje me genplanin përkatës, nga i cili rezulton se është dhënë leja për legalizimin e ndërtimit pa leje, sipas aplikimit të subjektit të – kartela e pasurisë së paluajtshme dhe certifikata e regjistrimit të pronësisë me fragmentin e hartës treguese;
- ii. kartelën e pasurisë, nga e cila rezulton se pasuria apartament me sip. 48.9 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, është regjistruar me aktin e fitimit të pronësisë “leje legalizimi nr. 52” (të përcjellë edhe nga subjekti);
- iii. certifikatën e regjistrimit të pronësisë, datë 18.5.2021.

**2.1.4** Komisioni iu drejtuar me shkresë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zonat e Stimuluara<sup>14</sup>, për informacion mbi aktet noteriale dhe veprimet juridike të lidhura ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A.D. për pasuri të ndodhura në objektin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., mbi të cilat këto palë mund të kenë fituar të drejta reale për pasuri të ndryshe dhe nga ASHK-ja përcillen vetëm praktikrat e trajtuara më sipër për legalizim dhe të aplikuar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me dokumentacionin e legalizimit të objektit të ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**2.1.5** Referuar shkresës kthim përgjigje të OSHEE-së<sup>15</sup>, konfirmohet se identifikohet një abonent me të njëjtat gjeneralitete si subjekti i rivlerësimit, z. Isa R. Jata, i cili rezulton të ketë lidhur kontratë për furnizimin me energji elektrike prej shtatorit të vitit 2014, në Kavajë.

**2.2** Në analizë të përmbajtjes së dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të përcjellë nga subjekti, si dhe dokumentacionit nga korrespondenca institucionale e Komisionit, trupi gjykues konstatoi se në të njëjtën datë, 11.5.2010, janë nënshkruar disa akte noteriale me palë subjektin e

<sup>11</sup>Shihni pyetësorin nr. 2, përgjigja nr. 1.4.

<sup>12</sup>Shihni plotësimet në përgjigjen e pyetësorit nr. 2, datë 18.12.2020.

<sup>13</sup>Me shpjegimet e tij bashkëlidh edhe dokumentacionet: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020, e ASHK-së; faturë e “Credins Bank” për pagesë truallit ose parcelë zone turistike në shumën 31,099 lekë; formular i pagesës së çmimit të truallit të njësisë së ndërtuar; formular i tarifës së përditësimit të pronës; faturë për arkëtim nr. \*\*\*, datë 29.12.2020; faturë për arkëtim nr. \*\*\*, datë 29.12.2020; faturë e “Credins Bank”, tarifë shërbimi në zonë turistike në shumën 526 lekë.

<sup>14</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 20.4.2021.

<sup>15</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 7.12.2020, në dosjen e Komisionit.

rivlerësimit, shtetasin A. D. dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për veprime juridike të tjetërsimit të pasurisë apartament në G., të cilat janë si vijon:

- kontrata e sipërmarrjes e lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe z. Isa Jata;
- deklarata noteriale e shtetasit A. D. dhe z. Isa Jata;
- revokim kontrate nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasit A. D. .

**2.3** Në këto akte noteriale, me anë të të cilave janë kryer veprimet e tjetërsimit të pasurisë, Komisioni konstatoi pasaktësi, si dhe faktin se janë të paqarta në përmbajtjen e tyre.

**2.4** Në aktin noterial, revokim kontrate, datë 11.5.2010, të lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasit A. D., referuar përmbajtjes së tij ka paqartësi, pasi në të njëjtin akt noterial kryhen dy veprime juridike të cilat kundërshtojnë njëra-tjetrën. Në përmbajtjen e këtij akti noterial përshkruhet se revokohen aktet noteriale të mëparshme të lidhura midis palëve dhe njëkohësisht, po me këtë akt noterial, bëhet edhe ndryshimi i aktit i cili revokohet (zëvendësimi i apartamentit të mëparshëm në katin e tretë, të porositur nga ky shtetas, me një apartament në katin e dytë).

**2.5** Kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, e lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me objekt “shitjen e apartamentit me sip. 53 m<sup>2</sup>”, me çmim shitjeje 18,550 euro, është kryer me qëllim formalizimin e një veprimi juridik të kryer më parë. Subjekti ka deklaruar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*rep., datë 11.5.2010, se *kjo kontratë është një akt formal sepse apartamenti ishte shitur tashmë nga shtetasi A.D. tek subjekti i rivlerësimit dhe qëllimi i lidhjes së saj ishte vetëm për të garantuar z. Isa Jata*. Gjithashtu, subjekti vijon të nënshkruajë akte noteriale në dukje formale për këtë pasuri, si deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, me deklarues shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku deklarohet se z. Isa Jata ka shlyer të gjithë shumën për apartamentin.

**2.6** Subjekti,<sup>16</sup> në lidhje me paqartësinë në këto akte, i pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar se: *“Për apartamentin në fjalë, siç kemi deklaruar edhe në deklaratën noteriale blerjen e tij, e kam bërë duke likuiduar shtetasin A.D., në shumën 30,000 euro, çmim për të cilin ramë dakord në gjendjen që ishte apartamenti, gjendje e cila është pothuajse e njëjta edhe sot e kësaj dite. Siç thuhet në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 15.11.2010, kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, është akt formal/fiktiv, ajo ka mbetur në formatin që ishte përpiluar para noteres M.Sh., ndërmjet palëve A. D. me B. T. dhe për këtë kontratë me nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, nuk ka pasur asnjë zhvillim për përmbushjen e saj, për faktin e cituar në deklaratën noteriale, vetëm për arsye të pamundësisë së lidhjes së një kontrate shitjeje përfundimtare, sepse apartamenti është i pahipotekuar. Shkak i vetëm për hartimin e një kontrate të tillë në formatin e kontratës së mëparshme, e cila, mbeti sikur unë po blija apartamentin nga investitori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ishte pamundësia e lidhjes së një kontrate shitjeje përfundimtare, sepse apartamenti është i pahipotekuar, kjo nën konsulencën e noteres Sh. ‘Ky veprim bëhet për faktin se godina nuk është regjistruar pranë ZVRPP-së Kavajë për pronësinë e këtij apartamenti në të ardhmen’.*

*Në momentin e blerjes së apartamentit nga ana ime si deklarues, fillimisht është revokuar kontrata e parë që kishte prenotuar A. D., me cilësinë e porositësit, me nr. \*\*\*, datë 25.2.2005, dhe më tej nën asistencën e noteres M. Sh. është përpiluar deklarata noteriale nr\*\*\*rep., datë 11.5.2010, me të cilën kemi shpjeguar të gjitha veprimet e kryera, si dhe faktin se shitjen ndaj meje I. J. të apartamentit e bëri A. D., i cili ka marrë prej meje, me cilësinë e blerësit, vlerën e plotë në shumën 30,000 euro, çka tregon se unë nuk kam pasur asnjë detyrim ndaj investitorit B. T. . Revokimi i kontratës është bërë me nr. \*\*\*, datë 11.5.2020, ndërmjet palëve me cilësinë e porositësit A. D. dhe investitorit B. T. Ndërsa, revokimi i kontratës së mëparshme nr\*\*\*, datë 25.2.2005, ndërmjet A. D. dhe B. T. në vetvete kishte pasur gabim për katin e ndodhjes së apartamentit. Në kontratën e*

<sup>16</sup>Shihni pyetësorin nr. 2, përgjigjja nr. 1.3.

*parevokuar shënohej kati i tretë, kur në të vërtetë është kati i dytë dhe apartamenti sot është i emërtuar me numër 9 (nëntë)”.*

Komisioni hetoi<sup>17</sup> në lidhje me kontratat e nënshkruara nga shtetasi A. D. me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., duke iu drejtuar noteres M. Sh., e cila përcolli kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 15.2.2005, të lidhur midis palëve të mësipërme dhe aneks kontratën nr. \*\*\*, datë 23.3.2007. Në kontratën e sipërmarrjes përcaktohet se i shitet shtetasit A. D. nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. apartamenti në katin e tretë, me sip. 53 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit të blerjes 18,550 euro. Ndërsa me aneks kontratën e nënshkruar në datën 23.3.2007, palët bien dakord se apartamenti nuk do të jetë në katin e tretë banim, por në katin e dytë banim.

**2.7** Në kontratën e sipërmarrjes parashikohet se shtetasit A.D. i shitet nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. apartamenti me sip. 53 m<sup>2</sup>, në katin e tretë, kundrejt çmimit të blerjes 18,550 euro. Ndërsa, me aneks kontratën e nënshkruar në datën 23.3.2007, palët bien dakord se apartamenti nuk do të jetë në katin e tretë të banimit por në katin e dytë të banimit.

**2.8** Komisioni hetoi çmimin e blerjes, duke iu referuar vlerave të tregut të lirë të apartamenteve nga EKB-ja<sup>18</sup>, nga e cila nuk rezulton vlerë për zonën e pasurisë të ndodhur në G. . Për këtë arsye u morën në krahasim dy zona të tjera kufitare, si Durrësi dhe Kavaja. Vlera e shitjes së apartamenteve sipas EKB-së në zonën e Durrësit është 73,968 lekë/m<sup>2</sup> (në total 3,920,304 lekë) dhe në zonën e Kavajës është 58,327 lekë/m<sup>2</sup> (në total 3,091,331 lekë). Sa më sipër, rezulton se vlera e shitjes së apartamentit në shumën 30,000 euro, e konvertuar në 4,164,300 lekë, është më e lartë se referencat nga EKB-ja.

**2.9** Në lidhje me konfliktin e interesit, Komisioni hetoi për shtetasit A.D. dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe administratorët e saj, shtetasit B. T. dhe E.T. Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>19</sup>, e cila përcolli informacionin se për shtetasit e mësipërm nuk ka pasur procedime penale të hetuara, vendime mosfillmi, pushimi apo të dërguara për gjykim nga subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e funksionit të tij.

**2.10** Gjithashtu, Komisioni hetoi edhe për njohjen midis shtetasit A. D. dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku subjekti<sup>20</sup> sqaroi se: *“Unë nuk kam dijeni për marrëdhënien mes tyre, por i pyetur A. D. nga ana ime me telefon, më konfirmoi se nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie miqësore apo interesi me të, por ka pasur vetëm njohje si investitor me ‘Investitorin shoqëria ‘\*\*\*\*’ sh.p.k.’. Me shtetasin B. T. ka pasur thjesht marrëdhënie shitblerjeje të apartamentit në fjalë, gjetjen e të cilit e ka konstatuar gjatë fazës së ndërtimeve që po kryheshin nga kjo shoqëri në këtë kompleks. Ky konstatim sipas A.D. është bërë në një fundjavë kur familjarisht kanë shkuar në plazh për pushime ditore në G. . Ndërsa, lidhur me apartamentin në fjalë, ai më ka thënë se: ‘Kur është hartuar kontrata mes tyre, kanë gabuar për katin ku ndodhej apartamenti. Faktikisht, apartamenti ndodhet në katin e dytë të ndërtimit të godinës (ky që jam unë aktualisht), ndërsa në kontratën e parë ishte shënuar apartamenti në katin e tretë. Kjo gjë është konstatuar me vonesë dhe në gjendjen që ishte përpiluar kontrata i takonte sikur kati i tretë i këtij pallati nën çati të ishte shitur dy herë, një herë A.D. dhe një herë tjetër personit që aktualisht ka blerë katin e tretë. Në këto kushte, A. D. kishte tentuar dhe më parë me shtetasin B.T.. për të revokuar atë kontratë dhe hartuar kontratë të re, por, nuk ishte bërë e mundur, pasi nuk kishin gjetur moment të përbashkët për të shkuar para noterit për këtë veprim. Në lidhje me sa më ka konfirmuar shtetasi A. D. nëse e çmoni të nevojshme mund ta pyesni me cilësinë e dëshmitarit shtetasin A. D., ai disponon numrin e telefonit cel. 069 \*\*\*\*\* ”.*

<sup>17</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 2.4.2021, në dosen e Komisionit.

<sup>18</sup>Shihni udhëzimin nr. 3, datë 3.2.2010.

<sup>19</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 4.5.2021.

<sup>20</sup>Shihni pyetësin nr. 2, përgjigjja nr. 1.2.

## **2.11 Në lidhje me pagesat e shlyera për apartamentin e ndodhur në G. . Komisioni analizoi dhe vlerësoi, si vijon:**

**2.11.1** Referuar përmbajtjes së akteve noteriale të lartpërmendura për tjetërsimin e kësaj pasurie, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkuan shpjegime mbi vlerën e paguar për apartamentin dhe ndaj kujt ishte paguar kjo vlerë.

**2.11.2** Në deklaratën nr. \*\*\* rep., datë 11.5.2010, deklarohet se për apartamentin është shlyer shuma 30,000 euro dhe është paguar ndaj shtetasit A.D. . Ndërsa, në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 1.5.2010, citohet se subjekti ka shlyer vlerën 18,550 euro ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Gjithashtu, me deklaratën noteriale nr. \*\*, datë 22.4.2015, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka deklaruar se subjekti ka shlyer vlerën 18,550 euro për këtë apartament dhe nuk ka detyrime. Në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 1.5.2010, përshkruhet mënyra e pagesës së çmimit të shitjes së apartamentit, ku kësti i parë në shumën 5,000 euro do të shlyhet brenda datës 15.6.2010, ndërsa këstet e tjera do të shlyhen në marrëveshje midis palëve.

**2.11.3** Subjekti shpjegoi<sup>21</sup> gjatë hetimit, në lidhje me mënyrën e pagesës, vlerën dhe dakordësinë ndërmjet palëve për këtë pasuri, si vijon: *“[...] për shkak se shitësi kërkonte të merrte vlerën e shitjes sa më shpejt, ramë dakord që fillimisht unë të pyesja nëse do të mundësoja marrjen e një kredie bankare në vlerën 15,000 euro, pasi me gjendjen nga të ardhurat e kursimeve të mia mund të realizoja gjysmën e vlerës së apartamentit 15,000 euro. U interesova pranë ‘Credins Bank’, ku rezultoi se ishte e mundur marrja e kredisë.. Në këto kushte, ramë dakord për të blerë apartamentin në vlerën 30,000 euro, të cilat ramë dakord se do t’i jepeshin pas marrjes së kredisë në ‘Credins Bank’”*.

Subjekti depozitoi gjatë hetimit<sup>22</sup>, bashkëlidhur me shpjegimet, kontratën e lidhur me “Credins Bank”, për kredi afatmesme, me nr. \*\*\*, datë 25.5.2010, në të cilën vërehet se qëllimi i marrjes së kredisë është “për blerje apartamenti”.

**2.11.4** Bazuar në korrespondencën e Komisionit me “Credins Bank”<sup>23</sup>, në kuadër të procesit të rivlerësimit, konfirmohet marrja e kredisë prej subjektit në vlerën 15,000 euro, mënyra dhe vlera e tërheqjes, nga e cila rezultoi se subjekti ka tërhequr *cash* shumën 14,500 euro në datën 28.5.2010, datë e kalimit të kredisë.

**2.11.5** Gjatë hetimit, i pyetur<sup>24</sup> nga Komisioni në lidhje me mënyrën e shlyerjes së vlerës së apartamentit, subjekti ka shpjeguar se: *“... pagesën e apartamentit ndaj shitësit e kam realizuar pas tërheqjes si kredi të një shume prej 15,000 euro, si dhe kursimet e mia të cilat i kisha në banesë dhe me të ardhurat vjetore të vitit 2010 të miat dhe të bashkëshortes, kemi paguar në fund të vitit shitësin”*.

Gjithashtu, subjekti vijon me shpjegimet e tij dhe sqaron<sup>25</sup> se: *“Me rënien dakord për blerjen e apartamentit biseduam edhe për mënyrën e shlyerjes së kësaj shume, ku në mirëbesim të plotë me njëri-tjetrin u pranua që fillimisht të hartonim dokumentacion në atë mënyrë që do të na sugjerohej edhe nga noterja dhe më tej të vijonim me pagesat. Pagesat nga ana ime në bazë mirëkuptimit dhe besimit reciprok ndër mjet nesh, janë bërë duke i dhënë shtetasit A. D. pa ndonjë dokument, në mirëbesim të plotë, sasinë e parave për të cilat kemi rënë dakord për shitblerjen e apartamentit, duke i likuiduar në tri këste: (i) kësti i parë, menjëherë pasi u përpilua dokumentacioni për shitblerjen me revokimet e më tej me deklaratën noteriale. Në datën 11.5.2010 kam likuiduar*

<sup>21</sup>Shihni pyetësin nr. 2, përgjigjja nr. 1.5.

<sup>22</sup>Shihni provat e përcjella me pyetësin standard.

<sup>23</sup>Shihni shkresën nr\*\*\*prot., datë 4.12.2020, të “Credins Bank”.

<sup>24</sup>Shihni pyetësin standard, përgjigjja nr. 9. III.

<sup>25</sup>Pyetësi nr. 3, përgjigjja nr. 1.1.

shumën prej 5,000 (pesë mijë) euro; (ii) këstin e dytë e kam likuiduar ditën e tërheqjes nga banka të shumës 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, sapo i kam tërhequr nga “Credins Bank”; (iii) këstin e tretë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro e kam likuiduar në fundvitin 2010 dhe konkretisht në datën 28.12.2010, ku me pagesën edhe të kësaj vlere rezultoi e shlyer e gjithë shuma e përcaktuar në deklaratë, që është e njëjtë me çmimin e blerjes së apartamentit.

Në momentin e blerjes së deklaratës noteriale, për arsyet që kemi përshkruar në pyetësorin nr. 2, pasi duhej bërë edhe revokimi i kontratës së porosisë, është shënuar çmimi i shitblerjes së apartamentit ishte 30,000 euro dhe se likuidimi i plotë i shumës është bërë jashtë zyrës noteriale. Në deklaratën periodike për vitin 2010, të bërë në datën 21.3.2011, kemi deklaruar likuidimin e plotë të apartamentit me shënimet e njëjta që citohen edhe nga ana juaj. Asnjëherë deri më sot nuk kemi shënuar në ndonjë akt datat dhe mënyrën konkrete se si është bërë pagesa, vetëm në deklaratën noteriale nr. \*\*\*rep., datë 11.5.2010, jemi shprehur se jemi likuiduar në total për shumën e apartamentit prej 30,000 euro. Gjithashtu, edhe në deklaratën periodike të bërë nga ana ime për vitin 2010 kemi shënuar se likuidimi i shumës është bërë brenda vitit 2010”.

**2.12 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting se:** “Për likuidimin, veç kursimeve, është marrë edhe kredi afatmesme prej 15,000 euro pranë ‘Credins Bank’, Tiranë”.

Në DIPP-në të vitit 2010, subjekti ka deklaruar: “Vlera 30,000 euro, shlyer plotësisht. Tashmë është bërë pagesa e plotë. Për likuidimin e saj, veç kursimeve familjare, tërhoqëm një kredi afatmesme prej 15,000 euro pranë ‘Credins Bank’”.

**2.13 Komisioni, duke u mbështetur në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin provues ligjor, hartoi analizën financiare mbi mundësinë e kursimit nga subjekti me të ardhurat dhe kursimet deri në momentin e blerjes, e cila është paraqitur në tabelën si vijon:**

Periudha	1.1.2010 – 1.5.2010
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	666 964 lekë
Të ardhura nga avokatia nga bashkëshortja	250 000 lekë
Likuiditetet në bankë	(4) lekë
Kursime të deklaruara më 31.12.2009	3 300 000 lekë
Shpenzimet jetike	227 700 lekë
Shpenzime udhëtimi	25 605 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>963 3 lekë</b>

**2.14 Referuar analizës financiare të kryer rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të kursejë deri në datën e pagesës së apartamentit shumën 3,963,663 lekë ose 28,555 euro.**

**2.15 Në tabelën vijuese, Komisioni analizoi në mënyrë të përmbledhur mënyrën dhe mundësinë e krijimit të kësaj pasurie me burime të ligjshme, nga e cila rezultoi se subjekti ka pamundësi financiare në vlerën 1,445 euro ose 200,637 lekë, për kryerjen e pagesës totale të apartamentit në vlerën 30,000 euro, me të ardhura të ligjshme.**

	Vlera	Rezultoi nga hetimi
Kredia e marrë në “Credins Bank”	15,000€	Shuma e tërhequr nga subjekti në datën 28.5.2010 është 14,500 euro, e cila nuk është konsideruar deri në këtë moment.

Kursimet dhe të ardhurat familjare	15,000€	Referuar analizës së mësipërme të hartuar nga Komisioni, rezulton se vlera totale e kursimeve nga të ardhurave deri në datën e blerjes është 3,963,663 lekë ose 28,555 euro.
<b>Totali</b>	<b>30,000€</b>	<b>28,555€</b>

**2.16** Në analizë të dokumentacionit, shpjegimeve të përcjella nga subjekti dhe hetimit të kryer nga Komisioni për këtë pasuri në lidhje mënyrën e pagesës së apartamentit në G., Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi dhe i kaloi barrën e provës subjektit, si vijon:

- i. Për kryerjen e pagesës së vlerës së blerjes së apartamentit u konstatua se është bërë *cash* dhe jo me transferta bankare, për këtë arsye dhe për shkak të mosparaqitjes së dokumentacionit justifikues ligjor për pagesa, subjekti nuk arriti të provonte në mënyrë shteruese vlerën e shlyer dhe ndaj kujt subjekti tregtar ose individ është kryer pagesa.
- ii. Qëndrimi i subjektit lidhur me pagesat e kryera për apartamentin në G. është kontradiktor dhe i paqartë. Gjithashtu, dokumentet e hetuara nga Komisioni për pagesat e kryera për këtë pasuri konstatohet se janë në dukje formale.
- iii. Bazuar në kontratën e sipërmarrjes të nënshkruar midis shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit parashikohet se mënyra e pagesës do të jetë: kësti i parë 5,000 euro brenda datës 15.6.2010; dhe këstet e tjera me marrëveshje midis palëve. Ndërkohë, sipas deklaratës noteriale të datës 11.5.2010, deklarohet se subjekti i ka paguar vlerën 30,000 euro shtetasit A.D., pra ka kryer likuidimin total. Ndërsa kredia e marrë në “Credins Bank” është kaluar në llogari të subjektit dhe është tërhequr në datën 28.5.2010.

**2.17** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës, subjekti ka parashtruar se: *“Lidhur me mënyrën e pagesës, theksoj se në vitin 2010 nuk kishte ndonjë përcaktim ligjor që të rregullonte se si duhet të kryhej pagesa në raste shitblerjesh të pasurive të paluajtshme, në cash apo nëpërmjet transfertave bankare. Për sa i përket dokumentacionit justifikues ligjor për pagesat, vlerësoj se pagesa është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë shteruese dhe se ndaj kujt është bërë. Janë pikërisht ato akte të cilat janë vlerësuar nga Komisioni, të deklaruara saktë në deklaratën periodike të vitit 2010 dhe deklaratën Vetting, me të cilat janë pasqyruar plotësisht saktë veprimet sipas përpilimit në deklaratën noteriale para noterit publik. Gjithashtu, deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 17.4.2021, e shitësit A. D., e dorëzuar në përgjigje të pyetësorit nr. 3, sqaron më së miri pagesën në tri këste të kryer gjatë vitit 2010.*

*Faktikisht, nga përmbajtja e deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., datë 11.5.2010, nuk ka mbetur asgjë kontradiktore dhe e paqartë, ajo ka sqaruar arsyet e kryerjes së veprimeve të cituara në të për shkakun e vetëm që pas tyre të ekzistonte mundësia që unë si blerës të kisha mundësinë e regjistrimit të pronësisë. Sërish, deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 17.4.2021, e shitësit A. D., plotëson më së miri këtë veprim të kryer gjatë vitit 2010 dhe largon çdo keqkuptim për formalitet apo fiktivitet në dukje të pagesave të kryera.*

*Është me shumë rëndësi të nënvizohet fakti se në përmbajtjen e deklaratës noteriale nr.\*\*\*, datë 11.5.2010, nënshkruar përpara noterit M.Sh., deklaruesit (shtetasi A. D. dhe Isa Jata) janë shprehur: ‘Ky akt është një veprim formal, pasi në fakt ky apartament z. Isa Jata i është shitur nga A.D. kundrejt shumës 30,000 euro, pra me një diferencë prej 11,450 euro, që është përfitimi i z. A. D. nga ky disponim i apartamentit në dobi të z. Isa Jata’. Më duket se pikërisht këtë deklaram të palëve, Komisioni e trajton si deklaram të shlyerjes tërësore të detyrimit. Në fakt, në këtë deklaram noteriale nuk cilësohet në asnjë moment fakti i likuidimit tërësor të shumës prej 30,000 euro nga subjekti i rivlerësimit tek shtetasi A. D. .*

*Kërkojmë nga Komisioni të vlerësojë me objektivitet deklarin e saktë dhe të detajuar që kam bërë si në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, ashtu edhe në deklaratën Vetting, se pagesa është kryer në 3 këste dhe momente të ndryshme dhe ky fakt pasqyrohet i tillë edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 21.3.2011), pra pak muaj më pas, citoj: ‘Shlyer plotësisht vlera e mësipërme prej 30,000 euro. Tashmë është bërë pagesa e plotë.’ Sa sipër, kur në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, nuk është cilësuar në asnjë moment mbi likuidimin tërësor të shumës prej 30,000 euro, vlerësojmë se përfundimi i arritur nga Komisioni se subjekti ka pamundësi financiare për krijimin e pasurisë në vlerën 1,445 euro ose 200,637 lekë, nuk është i bazuar në rrethanat reale të blerjes së kësaj pasurie.*

*Për sa u përshkrua më sipër, del plotësisht e qartë se midis shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k. dhe meje, subjektit të rivlerësimit, realisht nuk ka pasur ndonjë detyrim reciprok, por veprimi i përshkruar në deklaratën noteriale dhe i pranuar nga palët ishte për arsyen e vetme të garantimit të blerësit për regjistrimin e pasurisë në të ardhmen. Nga vështrimi i përmbajtjes së kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 25.1.2005, ndërmjet A. D. dhe investitorit B. T. konstatohet se ajo është e njëjtë me atë të shënuar formalisht me kontratë sipërmarrje nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, ndërmjet meje dhe investitorit të shoqërisë”.*

Subjekti, së bashku me prapësimet, ka përcjellë provat, si vijon:

- a) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 17.4.2021, e shitësit A. D.;
- b) kontratë nr. \*\*\*, datë 25.1.2005, si dhe aneks kontratë nr. \*\*\*, datë 23.3.2007, të cilat i janë revokuar shitësit A. D. (paraqitur për herë të parë në Komision);
- c) revokim kontrate nr. \*\*\*, datë 11.5.2010; deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., datë 11.5.2010; kontratë sipërmarrje nr. \*\*\*, datë 11.5.2010, bashkëlidhur kontratës vendimi i komunës G., vendimi i KKRT-së; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, aplikime pranë ALUIZNI-t;
- d) vendim nr. \*\*\*, datë 18.2.2021, për legalizimin e ndërtimit pa leje me genplanin përkatës;
- e) kartelë e pasurisë së paluajtshme, fragment i hartës kadastrale dhe kërkesa për aplikim pranë ASHK-së;
- f) certifikatë e regjistrimit të pronësisë e datës 18.5.2021.

Nga provat e përcjella për herë të parë të renditura në gjerat “d”, “e” dhe “f”, me prapësimet në analizë të përmbajtjes së tyre, rezulton se me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.2.2021, subjektit të rivlerësimit i është dhënë leja për legalizimin e ndërtimit pa leje, sipas aplikimit të subjektit të rivlerësimit, me nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2015, për apartamentin me sipërfaqe banimi 48.9 m<sup>2</sup>. Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, fragmentit të hartës treguese dhe certifikatës së regjistrimit të pronësisë, rezultoi se pasuria apartament me sip. 48.9 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, është regjistruar në datën 18.5.2021 me aktin e fitimit të pronësisë “leje legalizimi nr\*\*\*” (të përcjellë edhe nga subjekti). Nga hetimi ka rezultuar se leja e legalizimit nuk është rezultat i ndërtimit pa leje të kryer nga subjekti, por nga shoqëria e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe leja është vendimi për kualifikimin e ndërtimit informal/fiktiv nr. \*\*\*, datë 19.6.2018, e Agjencisë së Legalizimit, Drejtoria Zonat Turistike, ku vendoset legalizimi informal/fiktiv i kësaj shoqërie dhe vendimi nr. \*\*\*, i KRRT-së, komuna G. . Sa më sipër, forma ligjore për regjistrimin e saj është pikërisht procedura e legalizimit, sipas ligjit nr. 20/20, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, kreu III “Ndërtimet pa leje, objektet pa titull pronësie dhe oborret në përdorim”, pika 5 e nenit 17, dhe nenet 22 dhe 25.

**2.18** Në konkluzion të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit nga korrespondenca institucionale e Komisionit, shpjegimeve, deklarimeve dhe provave të përcjella nga subjekti pas

dërgimit të barrës së provës, pasi e dëgjoji në seancën dëgjimore, trupi gjykues çmon si më poshtë vijon:

- i. Aktet noteriale, të nënshkruara për kalimin e pronësisë së pasurisë objekt gjykimi, dëshmojnë për një situatë juridike, e cila në kushtet e mungesës së dokumentacionit të pronësisë së shtetasit A. D. mbi këtë apartament, kanë bërë që subjekti i rivlerësimit të lidh kontrata, të cilat, siç edhe është parashikuar po në akte noteriale, janë formale. Mjeti ligjor i zgjedhur nga subjekti, pra tërësia e akteve të nënshkruara prej tij, me qëllim rregullimin e situatës juridike, nuk parashtronë problematika, të cilat të çojnë në një deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të subjektit për këtë pasuri. Në mënyrë të saktë e të plotë dhe në deklaratat periodike subjekti e ka pasqyruar panoramën e situatës juridike të tij për përfitimin e këtij apartamenti. Një argument tjetër në këtë analizë përbën fakti i çmimit të parashikuar në deklaratën noteriale, i cili është më i lartë se ai i parashikuar në kontratën e sipërmarrjes së subjektit me firmën e ndërtimit. Trupi gjykues çmon se nuk është objekt i këtij gjykimi se cila do të ishte rruga ligjore të cilën duhet të ndiqte subjekti për të eliminuar nënshkrimin e akteve, të cilësuar prej tij si formale. Në funksion të ligjit këto konstatime përbëjnë elemente që lidhen me anën etike të magjistratit, e cila në përfundim të gjykimit do të vlerësohet në tërësi dhe harmoni me të gjitha provat dhe faktet e tjera, që kanë rezultuar nga ky proces rivlerësimi. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se problematikat e konstatuara nuk krijojnë dyshime në drejtim të pamjaftueshmërisë së deklaramit të subjektit për këtë pasuri në drejtim të mënyrës së përfitimit të saj.
- ii. Trupi gjykues, me qëllim përcaktimin në mënyrë të saktë të vlerës së shlyer, si dhe kohës së shlyerjes së kësteve, në analizë të përmbajtjes së akteve noteriale të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, të deklarameve të dhëna prej tij në DIPP, si dhe qëndrimet koherente gjatë procesit të rivlerësimit, çmon se koha dhe vlerat e shlyera nga subjekti përputhen me deklaramet e bëra prej tij gjatë procesit të rivlerësimit dhe, konkretisht, shuma 5,000 euro është likuiduar në datën e nënshkrimit të akteve noteriale, shuma 15,000 euro pas marrjes së kredisë në “Credins Bank” dhe deri në fund të vitit 2010 me kursimet vjetore të subjektit dhe bashkëshortes pjesa e mbetur prej 10,000 euro. Ky qëndrim është pasqyruar edhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni (të analizuar në pikën 2.16).

**3. Automjet tip “Renault Megane”, me targa \*\*\*, viti i prodhimit 1996, blerë në vitin 2006, ende në funksionim.** Deklaram në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006. Vlera: 540,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti ka deklaram si burim të krijimit kursimet ndër vite.

**3.1** Nga hetimi rezultoi se subjekti e ka deklaram për herë të parë pasurinë në DIPP-në të vitit 2006: *“Autoveturë e përdorur tip ‘Renault Megane’, prodhim i vitit 1996, blerë më 13.4.2006. Vlera 540,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %”*. Në DIPP-në e vitit 2006 subjekti nuk ka deklaram burim të krijimit të pasurisë.

**3.2** Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka përcjellë<sup>26</sup> dokumentacionin, si vijon:

- i. lejen e qarkullimi të automjetit me targa \*\*\*, në emër të Isa Jata;
- ii. dokumentacionin ligjor të blerjes së automjetit në Gjermani nga Isa Jata, i cili përmban kontratën e shitblerjes, datë 13.4.2006, librezja e automjetit; dokumenti i çregjistrimit; deklaramata e zhdoganimit; taksa vjetore 2016 dhe policja për sigurimin e automjetit datë 7.7.2016.

**Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

**3.3** DPSHTRR-ja<sup>27</sup> ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targa \*\*\* dhe ka përcjellë në Komision kontratën e shitblerjes së automjetit tip “Renault Megan”,

<sup>26</sup>Shihni aneksin nr. 4/3, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>27</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 3.12.2020, të DPSHTRR-së.



nënshkruar në datën 13.4.2006, të lidhur në Frankfurt, Gjermani, midis palës shitëse K.O. dhe palës blerëse Isa Jata, me vlerë 1,900 euro. Gjithashtu, përcillet dokumenti i çregjistrimit nga shtetasi gjerman K. O., lëshuar në datën 8.2.2006 dhe libreza e automjetit lëshuar për këtë shtetas në Gjermani. Sipas fletës së doganës Durrës automjeti ka hyrë në territorin shqiptar në datën 27.4.2006, me vlerë 1,900 euro, për të cilin janë paguar detyrimet doganore në vlerën totale 172,715 lekë. Gjithashtu përcillet edhe vërtetimi i lëshuar nga DPSHTRR-ja, Drejtoria Rajonale Tiranë, në datën 17.7.2019, për nxjerrjen nga qarkullimi përfundimisht të automjetit të mësipërm në datën 17.7.2019.

**3.4** Subjekti e ka deklaruar në DIPP-në të vitit 2019 nxjerrjen jashtë përdorimit dhe shitjen e saj për skrap në datën 17.7.2019, për të cilën ka përcjellë edhe kopje të *statement*-it bankar nga “Credins Bank”, me vlerë 37,000 lekë të blerë nga shtetasi Xh. Ç. .

**3.5** Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të krijimit të pasurisë kursimet ndër vite. Komisioni konstatoi se në DIPP-në të vitit 2006 subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj. Komisioni, mbi bazën e deklaramit të subjektit në deklaratën *Vetting*, hartoi analizën financiare si në vijim, duke konsideruar burim kursimet e deklaruar deri në fund të vitit 2005 dhe kursimet nga të ardhurat e vitit deri në datën e blerjes së automjetit, datë 13.4.2006.

Periudha	1.1.2006 – 13.4.2006
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	524 743 lekë
Të ardhura ofrimi i shërbimit të avokatisë i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit	216 667 lekë
Shpenzime për shkollimin e djalit në shkollë jopublike	40 000 lekë
Shpenzime jetike	146 076 lekë
Blerja e automjetit	540 000 lekë
Likuiditete në bankë	205 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>15.129 lekë</b>

**3.6** Nga sa më sipër, në konkluzion të hetimit administrativ, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të kryer shpenzime dhe për të krijuar këtë pasuri, duke rezultuar me një bilanc pozitiv në vlerën 15,129 lekë.

#### **4. Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni lidhur me deklarin e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar**

**4.1** Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: “Gjendje në banesë në momentin e deklaramit 450,000 lekë, pjesa takuese 100 %”.

Në lidhje me gjendjen likuiditet *cash*/kursime, subjekti ka deklaruar në DIPP-në të viteve 2003 - 2016, si më poshtë vijon:

DIPP 2003	Nuk deklaron
DIPP 2004	Kursime vjetore 0.45 milion lekë gjatë vitit 2004, pjesa takuese 100%
DIPP 2005	Gjendje lekë në banesë nga kursimet vjetore 850,000 lekë
DIPP 2006	Nuk deklaron
DIPP 2007	Nuk deklaron
DIPP 2008	Tërhequr nga “R*** B***”, depozita e çelur në datën 20.7.2006, me afat 3-vjeçar, vlera 321,700 lekë. Gjendje lekë në banesë nga tërheqja në bankë si më sipër, si dhe nga kursimet vjetore. Vlera 1,150,000 lekë
DIPP 2009	Gjendje lekë në banesë vlera 850,000 lekë

DIPP 2010	Gjendje lekë në banesë, aktualisht 450,000 lekë.
DIPP 2011	Gjendje lekë në banesë, aktualisht vlera 650,000 lekë
DIPP 2012	Gjendje lekë në banesë, aktualisht 450,000 lekë
DIPP 2013	Gjendje lekë në banesë, aktualisht 550,000 lekë
DIPP 2014	Përdorur për shpenzime në vitin 2014 gjendjen e parave <i>cash</i> në banesë nga viti 2013. Vlera 550,000 lekë
DIPP 2015	Përdorur për shpenzime në vitin 2015 gjendjen e parave <i>cash</i> në banesë nga viti 2014. Vlera 150,000 lekë
DIPP 2016	Gjendje në banesë në momentin e deklarimit. Vlera 450,000 lekë
<i>Vetting</i> , datë 26.1.2017	Gjendje në banesë në momentin e deklarimit. Vlera 450,000 lekë

**4.2** Subjekti, i pyetur<sup>28</sup> nga Komisioni për deklarimin e kursimit në vitin 2015, ka shpjeguar se: “*Sa i përket gjendjes së deklarimeve në fund të vitit 2014, rezulton se vërtet gjatë vitit 2014 nuk është arritur të kursehet ndonjë vlerë në cash, por, në vështrim të deklaratave të tre viteve të mëparshme, konstatohet se në banesë kisha të holla në lekë që e përballonin këtë vlerë e më shumë. Në vështrim të të gjitha deklarimeve të bëra, del në dukje se gjithnjë nuk kam trajtuar në detaje shtesat dhe pakësimet ndër vite. Tashmë e shikoj si një të metë për të cilën nuk kam reflektuar ndër vite... Gjithnjë, kur kam deklaruar dhe shënuar vlerën e kursimeve vjetore me të ardhurat e vitit në deklarim, ato në asnjë rast nuk i kam reflektuar në shtesë të viteve të mëparshme, duke bërë që të mungojë mbledhja e tyre në progresiv. Pikërisht kjo ka qenë arsyeja se unë kam shënuar si të përdorura 150,000 lekë në vitin 2015, si kursime të vitit 2012, por faktikisht kjo ka ndodhur nga mosshënimi në progresiv i shumave që bën të mos dalë që të kishte lekë në vitin 2014, kur faktikisht kishte shuma të mjaftueshme në lekë në banesë nga kursimet e viteve të mëparshme të filluara nga viti 2009”.*

Komisioni, gjatë analizës financiare, ka konsideruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit mbi gjendjet *cash* gjatë viteve 2003 - 2016, të cilat janë konsideruar si deklarime të shtesave në kursime dhe jo gjendje të tyre.

Në lidhje me burimin e krijimit të likuiditeteve *cash*, Komisioni ka konsideruar të ardhurat e viteve përkatëse dhe gjendjet e kursimeve nga vitet e mëparshme, të cilat janë pjesë e analizës financiare.

**Sa më sipër, subjektit iu dërgua barra e provës se ka mospërputhje të gjendjes *cash*, e cila rezulton nga përlllogaritja e tij sipas deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit, me gjendje 5,150,000 lekë, nga vlera e deklaruar gjendje në banesë në deklaratën *Vetting* në janar të vitit 2017, në shumën 450,000 lekë.**

**4.3** Subjekti, pas dërgimit të barrës së provës, me rezultatet e hetimit, ka shpjeguar, si vijon:

***i) Lidhur me deklarimin e kursimeve në DIPP-në e vitit 2015***

*“Në shpjegimet e dhëna lidhur me gjendjen cash dhe pikërisht të deklarimit tim për vitin 2015, ku kam deklaruar që kam shpenzuar shumën prej 150,000 lekësh të mbartur nga viti 2014, gjendje kjo që nuk duhet të rezultonte për shkak të deklarimit të vitit 2014, ku unë kam deklaruar ezaurimin e të gjithë gjendjes cash, duke u përpjekur të shpjegoj këtë pasaktësi, në fakt kam krijuar një situatë të keqkuptuar edhe nga ju, duke marrë deklaratimet cash në mënyrë progresive për të gjitha vitet e deklarimit. Në gjykimin e parë për shpjegimin e shumës 150,000 lekë kam konceptuar që ky deklarim i shumës cash nga viti 2014 duhet të ishte një mosdeklarim në mënyrë progresive të gjendjeve cash, për shkak se nuk mund të kisha bërë një deklarim të tillë pa ndonjë bazë të caktuar, por gjykoj që ky deklarim, i parë në një këndvështrim më të gjerë, mund të ketë ndodhur për arsye se unë mund të*

<sup>28</sup>Pyetësori nr. 3, përgjigjja nr. 3.

jem referuar gjendjes aktuale të deklarimit, çka mund të kem përfshirë në deklarim edhe tërheqjet nga banka gjatë asaj periudhe.

Deklarimi im në DIPPP-në e vitit 2015 është kryer në datën 21.3.2016.

DIPP e vitit 2015	Përdorur për shpenzime në vitin 2015 gjendjen e parave cash në banesë nga viti 2014. Vlera: 150,000 lekë
-------------------	--

Datë	Përshkrim	Debi	Kredi
7.1.2016	Kreditim në llogari, paga		134,033
12.1.2016	Tërheqje cash, Isa Jata	135,000	
1.2.2016	Kreditim në llogari, paga		134,033
4.2.2016	Tërheqje cash, Isa Jata	130,000	
1.3.2016	Kreditim në llogari, paga		134,033
7.3.2016	Tërheqje cash, Isa Jata	135,000	
		400,000	402,099

Deri në këtë datë, nga ana ime nga banka janë kaluar tre paga mujore, nga të cilat unë kam tërhequr si më poshtë:

Shpenzimet për jetesë për tre muaj janë në shumën  $879,992/4 = 219,998$  lekë dhe diferenca ndërmjet gjendjes cash të tërhequr dhe shpenzime për jetesë rezulton në shumën 185,002 lekë. Për këtë shkak duhet të kem deklaruar në DPV-në e vitit 2015 që gjendja cash nga viti i kaluar, pra nga viti kalendarik 2015, në shumën 150,000 lekë, duke iu referuar gjendjes cash në momentin e deklarimit, atë të datës 21 mars të vitit 2016.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj, dua të theksoj që deklarimi i cashit në banesë në kushtet kur nuk mbahen regjistrime apo deklarime në fund të vitit kalendarik, si dhe nisur edhe nga periudha tremujore e vitit pasardhës në të cilën gjenerohen të ardhura dhe shpenzime mund të më ketë çuar në pasaktësi”.

#### ii) Lidhur me mospërputhjen në gjendjen cash të deklaratave vjetore me deklaratën Vetting

“Në deklaratën periodike gabimisht kam deklaruar gjendjen prej 450,000 lekësh, duke iu referuar deklaratës Vetting si një deklaratë e saktë për sa i përket gjendjes cash.

Theksoj që në shpjegimet e mia që kam dhënë, duke dashur të justifikoj atë shumë prej 150,000 lekësh, duke e konsideruar të pamundur që të kem bërë një deklarim pa u bazuar diku, kam menduar që mund të ishte si pasojë e mosmbledhjes në mënyrë progresive të shumave cash që nga viti 2012, por që realisht konstatoj që ajo pasaktësi lidhet me mënyrën e deklarimit tim të gjendjes cash në të cilën unë jam referuar gjendjes cash aktualisht në banesë.

Në deklaratimet e mia lidhur me gjendjen cash, mënyrë e deklarimit nga viti 2010 ka të njëjtin format i cili është ‘gjendje në banesë aktualisht’ ose ‘gjendje në banesë në momentin e deklarimit’.

Ky deklarim nuk krijon keqkuptime dhe është i qartë që në këto periudha unë i referohem gjendjes së cashit dhe jo shtesave progresive të tyre.

Konsideroj të rëndësishëm këtë sqarim për shkak se mbi bazën e saj është e bazuar edhe analiza financiare. Keqkuptimi duke konsideruar deklarimet e gjendjes cash në mënyrë progresive me të drejtë çon në konkluzionin e një gjendjeje cash në fund të vitit 2016 në shumën 5,150,000 lekë, ku për asnjë rrethanë ekonomike, logjike dhe ligjore nuk mund të zotërohej nga unë dhe të mos deklarohet në deklaratën Vetting.

*Siç Ju keni konstatuar në vitet 2014 – 2015 - 2016 unë dhe familja ime, në kushtet e studimit të vajzës jashtë vendit, kemi qenë të shtrënguar në sakrificë ekonomike për të përballuar shpenzimet dhe nuk mund të kishte mundësi të dispononim një gjendje cash në shuma të tilla. Disponimi i një shume mbi 1,500,000 lekësh ishte i ndaluar dhe ishte i detyrueshëm depozitimi në institucionet bankare të çdo shumë mbi 1,500,000 lekë.*

*Për sa shpjegova më sipër, nëse do të paraqisja në tabelë, gjendja cash do të ishte sipas deklarimeve të kryera nga ana ime në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së. Konkretisht, ajo do të ishte si më poshtë:*

<i>DIPP 2003</i>	<i>Nuk deklaron</i>	<i>Gjendja cash në banesë</i>
<i>DIPP 2004</i>	<i>Kursime vjetore 0.45 milion lekë, gjatë vitit 2004, zotëron 100%</i>	<i>450,000 lekë</i>
<i>DIPP 2005</i>	<i>Gjendje lekë në banesë nga kursimet vjetore 850,000 lekë</i>	<i>850,000 lekë</i>
<i>DIPP 2006</i>	<i>Nuk deklaron</i>	<i>850,000 lekë</i>
<i>DIPP 2007</i>	<i>Nuk deklaron</i>	<i>850,000 lekë</i>
<i>DIPP 2008</i>	<i>Tërhequr nga "R*** B***", depozita e çelur në datën 20.7.2006, me afat trevjeçar, vlera 321,700 lekë. Gjendje lekë në banesë nga tërheqja në bankë si më sipër, si dhe nga kursimet vjetore. Vlera 1,150,000 lekë</i>	<i>1,150,000 lekë</i>
<i>DIPP 2009</i>	<i>Gjendje lekë në banesë, vlera 850,000 lekë</i>	<i>850,000 lekë</i>
<i>DIPP 2010</i>	<i>Gjendje lekë në banesë, aktualisht 450,000 lekë</i>	<i>450,000 lekë.</i>
<i>DIPP 2011</i>	<i>Gjendje lekë në banesë, aktualisht vlera 650,000 lekë</i>	<i>650,000 lekë</i>
<i>DIPP 2012</i>	<i>Gjendje lekë në banesë, aktualisht 450,000 lekë</i>	<i>450,000 lekë</i>
<i>DIPP 2013</i>	<i>Gjendje lekë në banesë, aktualisht 550,000 lekë</i>	<i>550,000 lekë</i>
<i>DIPP 2014</i>	<i>Përdorur për shpenzime në vitin 2014 gjendjen e parave cash në banesë nga viti 2013. Vlera 550,000 lekë</i>	<i>0 lekë</i>
<i>DIPP 2015</i>	<i>Përdorur për shpenzime në vitin 2015 gjendjen e parave cash në banesë nga viti 2014. Vlera 150,000 lekë</i>	<i>0 lekë</i>
<i>DIPP 2016</i>	<i>Gjendje në banesë në momentin e deklaramit. Vlera 450,000 lekë</i>	<i>370,000 lekë</i>
<i>Vetting, datë 26.1.2017</i>	<i>Gjendje në banesë në momentin e deklaramit. Vlera 450,000 lekë</i>	<i>450,000 lekë</i>

### **iii) Lidhur me gjendjen e kursimeve në vitin 2015**

*“Për shkakë që shpjegova më lart, lidhur me gjendjen cash kam pasur edhe pasaktësi për sa i përket gjendjes cash në vitet 2016 dhe 2015 [...] dhe në vitin 2015 nuk kam disponuar gjendje cash në fillim të vitit, edhe pse jam shprehur që kam përdorur gjendje cash nga viti 2014. Kjo, siç shpjegova më sipër, kam marrë në konsideratë kursimet e mia në tremujorin e parë të vitit 2016”.*

### **iv) Lidhur me gjendjen e kursimeve në vitin 2016**

*“Në vitin 2016 kam deklaruar gjendje cash në shumën 450,000 kur në fakt duhet të kem disponuar 370,000 lekë”. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar: “Gjendje në banesë në momentin e deklaramit. Vlera 450,000 lekë”.*

**4.4** Trupi gjykues, nisur nga analizimi i provave të administruara gjatë hetimit administrativ, deklaramet e subjektit përpara dhe gjatë hetimit administrativ, konstatimet e bëra në rezultatet e hetimit, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në seancën dëgjimore, në tërësi të kësaj çështjeje për këto likuiditete, arsyeton dhe vlerëson, si vijon:

**4.4.1** Deklaramet e subjektit të rivlerësimit lidhur me likuiditetet cash paraqiten konfuzë përballë detyrimit të tij ligjor, të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për të deklaruar me saktësi

ose plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur, në funksion të vazhimit të qëndrimit në detyrë, sikurse edhe me detyrimet e tij ligjore si funksion publik/subjekt i ligjit nr. 9409/2003.

**4.4.2** Plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i deklaratës *Vetting* dhe përputhshmëria e qëndrimit të subjektit gjatë hetimit ka rëndësi në zbatimin e duhur të kuadrit ligjor (neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës) dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe nënligjor, udhëzimi i ILDKPKI-së<sup>29</sup>, të cilët parashikojnë edhe pasojën ligjore të pasaktësisë dhe pavërtetësisë në deklarime<sup>30</sup>. Këto rregullime kërkojnë që subjektet e rivlerësimit të deklarojnë saktësisht dhe plotësisht pasurinë në rastin konkret likuiditetet *cash* jashtë sistemi bankar në lekë ose në valutë të huaj.

**4.4.3** Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>31</sup>, në vendimmarrjen e tij, ka referuar se në këndvështrim të kuadrit ligjor subjekti ka detyrë të deklarojë, duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurorë e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklarimeve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël, për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues.

**4.4.4** Për rrjedhojë, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin që të deklarojë në mënyrë të saktë dhe konform ligjit likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar.

**4.4.5** Komisioni, në realizimin e analizës financiare, mori në konsideratë deklaratimet e bëra nga subjekti si gjendje likuiditeti *cash* në DIPP-të e çdo viti, nisur nga fakti se këto të fundit përbëjnë provë konform ligjit nr. 84/2016 dhe janë deklarime të bëra në kohë reale, në çdo vit deklarimi.

**4.4.6** Subjekti i rivlerësimit mbajti një qëndrim reflektues dhe bashkëpunues në lidhje me çdo pasaktësi dhe paqartësi gjatë hetimit. Për pasojë, trupi gjykues çmon se moskonsistenca dhe mospërputhja e deklarimeve të subjektit dhe qëndrimi i mbajtur gjatë hetimit në deklaratimet e likuiditeteve *cash* është një konstatim, i cili, në përfundim të gjykimit, do të vlerësohet në tërësi dhe në harmoni me të gjitha provat dhe rrethanat e tjera që kanë rezultuar nga ky proces rivlerësimi.

**5. Depozitë në lekë me afat 12-mujor në “Credins Bank”, për periudhën 12.10.2014 – 28.12.2016, e cila ka lëvizje në debi në shumën 3.903,93 lekë. Vlera e depozitës: 640.166,44 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni**

**5.1** Fillimisht depozita është hapur nga bashkëshortja e subjektit V.J. nga derdhja *cash* e bërë prej saj në datën 7.2.2007 në llogarinë në “Credins Bank”, me vlerë 600,000 lekë.

---

<sup>29</sup> Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, zotërim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj. nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pika 17, deklarimi i gjendjes *cash* do të njihet si i tillë në koncept të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, deri në kufirin 1,500,000 lekë. Shuma më të mëdha duhet të formalizohen në sistemin bankar përpara dorëzimit të deklaratës në ILDKPKI, duke bashkëlidhur në çdo rast veprimin bankar për këtë veprim.

<sup>30</sup>Shihni faqen 59, <http://klgj.al/ep-content/uploads/2019/09/Paketa-e-Ligjeve-t%C3%AB-Reform%C3%ABs-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi-2018.pdf>

Sanksionet: Mosplotësimi saktë dhe me vërtetësi të deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjekteve të rivlerësimit sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe objekti i deklaratimit, paragrafi 27.12.16, <http://klgj.al/ep-content/uploads/2019/09/Paketa-e-Ligjeve-t%C3%AB-Reform%C3%ABs-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi-2018.pdf>

<sup>31</sup> JR 20/2019, faqja 18, paragrafi 56.

Subjekti<sup>32</sup>, gjatë hetimit, ka shpjeguar se: “[...] burimi i krijimit të vlerës së depozituar nga bashkëshortja në datën 7.2.2007, që ka shërbyer për krijimin e depozitës bankare, janë të ardhurat e përbashkëta nga unë Isa Jata, nga paga, si dhe të bashkëshortes V. J. në vitet 2005 e 2006 [...]”.

Ndërsa, në DIPP-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar se: “Bashkëshortja V. J. ka depozitë bankare në ‘Credins Bank’, me afat 2-vjeçar, hapur në datën 7.2.2007. Vlera: 600,000 lekë. Të ardhura gjatë vitit 2006”.

**5.2** Nga verifikimi i llogarive bankare, i kryer nga Komisioni, rezulton se në datën 14.2.2011 është bërë transferimi i fondeve të depozitës prej 600,000 lekësh, me interesat e akumuluar me vlerë 70,114 lekë (në total 766,610 lekë), nga llogaria e bashkëshortes në llogarinë e subjektit, brenda “Credins Bank”, me të cilat subjekti ka hapur depozitë 2-vjeçare në këtë bankë.

Subjekti ka shpjeguar<sup>33</sup> në lidhje me këtë transfertë se: “[...] kjo lëvizje është bërë për faktin se gjithnjë deklaratimet vjetore të pasurisë pranë ILDKPKI-së janë bërë në emrin tim në masën 100%, ndërsa të ardhurat e bashkëshortes janë shënuar në formularin tim të deklaratimit. Bashkëshortja, në autorizimin e saj, gjithmonë ka nënshkruar pa shënuar ndonjë pasuri apo të ardhur në emër të saj, pasi ato shënoheshin në deklaratën time periodike. Që në fillim të deklaratimit e deri edhe aktualisht është mbajtur e njëjta linjë, duke deklaruar çdo të ardhur familjare vetëm në emrin tim si subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së”.

Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioni hartoi tabelën, si vijon:

Data e veprimit	Vlera e depozitës
Datë 7.2.2007, hapja e depozitës	600,000 lekë
Datë 9.2.2009, rihapje e saj me interesat	600,000 lekë + interesat 70,114 lekë = 670,114 lekë
Datë 7.2.2011, maturimi i depozitës 2-vjeçare	670,114 lekë + 96,496 lekë = 766,610 lekë
Datë 14.2.2011, transferim i fondeve nga llogaria e bashkëshortes tek llogaria e subjektit dhe rihapje depozite prej tij me afat 2-vjeçar	766,610 lekë
Datë 15.2.2013, maturim dhe rihapje e depozitës 6-mujore	766,700 lekë + 96,503 lekë = 863,203 lekë
Datë 13.10.2014, maturim i depozitës dhe kalim në depozitë të re me afat 12-mujor	614,140 lekë
Datë 13.10.2016, depozita vazhdon të jetë aktive	636,263 lekë

Në lidhje më burimin e krijimit të vlerës së derdhur *cash* (600,000 lekë) nga bashkëshortja, duke iu referuar analizës financiare të vitit 2006, e cila ka rezultat financiar prej 853,057 lekësh në fund të vitit, rezulton se subjekti ka pasur mundësi të kursejë vlerën e derdhjes *cash*. Subjekti/bashkëshortja nuk ka deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2006 vlerën e derdhjes *cash* nga bashkëshortja në datën 7.2.2007, të përdorur për krijimin e depozitës.

Në tabelën si vijon është paraqitur përmbledhja e analizës financiare për vitin 2016.

<sup>32</sup>Pyetësi nr. 3, përgjigja nr. 2.

<sup>33</sup>Pyetësi nr. 3, përgjigja nr. 2.

<b>Periudha</b>	<b>Viti 2016</b>
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit	1,574,230 lekë
Të ardhura nga avokatia nga bashkëshortja	650,000 lekë
Ndryshimi i gjendjes se likuiditeteve në bankë dhe <i>cash</i>	320,945 lekë
Blerja e automjetit tip “R*** M***”, me targa ***	540,000 lekë
Shpenzime për arsimimin në shkollë private të djalit	72,000 lekë
Shpenzimet jetike	438,228 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	<b>853,057 lekë</b>

**5.3** Në konkluzion të sa më sipër, referuar analizës financiare dhe përmbajtjes së dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë pasurinë monetare me të ardhura të ligjshme.

**6. Llogari rrjedhëse si balancë kreditore, në vlerën 2.61 lekë dhe llogari nr\*\*\*, si balancë kreditore, në vlerën 5 euro, në “Credins Bank”**

**6.1** Nga verifikimi i llogarive të subjektit në “Credins Bank”<sup>34</sup> konfirmohen balancat e deklaruara prej tij në deklaratën *Vetting*.

**7. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, në seksionin e “detyrimeve financiare”, si vijon:**

**7.1** Lidhur me detyrimet financiare, subjekti ka deklaruar: “*Para të nisura nga llogaria ime në vitet 2014, 2015 dhe 2016 dërguar me transfertë bankare nga ‘Credins Bank’ për studime, fillimisht në Universitetin H., Gjermani. Në vitin 2014, 10,500 euro, në vitin 2015, 10,000 euro dhe në vitin 2016, 5,000 euro. Në total për tre vitet janë dërguar gjithsej 25,500 euro të krijuara nga kursimet familjare ndër vite, të cilat janë deklaruar në deklaratat periodike sipas viteve përkatëse*”.

**7.2** Ndërsa, vajza E. J. ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore ndër vite të subjektit të rivlerësimit, si vijon:

- a) *Në DIPP-në të vitit 2016, vlerë në llogarinë rrjedhëse me nr. konto \*\*\*, me gjendje 5,268.26 euro, të transferuara nga prindi Isa Jata për vazhdimin e studimeve, gjithsej 5,000 euro, për vitin shkollor deri në 1 shtator 2017. Transferuar nga “Credins Bank” nr. \*\*\*, datë 5.9.2016.*
- b) *Në DIPP-në e vitit 2015, para në llogarinë time, të nisura me transfertë bankare nga “Credins Bank”, për përfundimin e studien-Kolleg, në H., Gjermani. Nisur 500 euro, për vitin shkollor deri në 1 shtator 2015. Nisur nga prindi Isa R. Jata. “Credins Bank” me nr. transferte \*\*\*, datë 15.6.2015. Shpenzuar plotësisht.*
- c) *Para në llogarinë time, të nisura me transfertë bankare nga “Credins Bank”, për vazhdimin e Universitetit Informatikë Mjekësore, në H. . Nisur gjithsej 1,500 euro, për vitin shkollor deri në 1 shtator 2016. Nisur nga prindi Isa R. Jata. “Credins Bank” me nr. \*\*\*, datë 13.7.2015. Shpenzuar plotësisht.*
- d) *Para në llogari time, të nisura me transfertë bankare nga “Credins Bank”, për vazhdimin e Universitetit Informatikë Mjekësore, në H. . Gjendje: 617.78 euro. Nisur gjithsej 8,000 euro për vitin shkollor deri më 1 shtator 2016. Nisur nga prindi Isa Jata, “Credins Bank” me nr. \*\*\*, datë 7.9.2015.*

<sup>34</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.12.2020, të “Credins Bank”.

- e) Për vitin 2014, para në llogarinë time, të nisura me transfertë bankare nga “Credins Bank”, për përfundimin e studien-Kolleg, në H., Gjermani. Gjithsej 8,000 euro. Kjo shumë për të kryer shpenzimet e nevojshme për vitin shkollor 2014 – 1 shtator 2015. Prindi Isa R. Jata. “Credins Bank” me nr\*\*\*, datë 13.10.2014. Shpenzuar plotësisht.
- f) Para në llogarinë time, të nisura me transfertë bankare nga “Credins Bank”, për shpenzime në kurse të gjuhës gjermane gjatë vitin 2014. Shuma e sjellë 2,500 euro nga babai Isa Jata, nëpërmjet “Credins Bank” Tiranë, nr. \*\*\*, datë 2.7.2014. Shpenzuar plotësisht.

**7.3** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur<sup>35</sup> nga Komisioni për shpenzimet e vajzës së tij E. J. gjatë kohës së qëndrimit në Gjermani, ka shpjeguar se: “Kostot faktike të jetesës së vajzës time E. J. në Gjermani përbëhen nga qiratë (përveç disa periudhave ku ka jetuar, e regjistruar në mënyrë të rregullt në bashkitë përkatëse në Gjermani, në 3 familje të ndryshme), sigurimi shëndetësor, tuition fee, si dhe shpenzimet për ushqime e veshmbathje, libra dhe transport publik.

- a) Sigurimet shëndetësore në kohën si Au Pair janë paguar nga familja B. . Qëkur ka filluar të studiojë E. paguan sigurimin shëndetësor si studente që në vitin 2014 pranë AOK Baden-Württemberg. Shuma e pagesës për muaj ka filluar nga afërsisht 79 euro, në tetor të vitit 2014 dhe është rritur gradualisht në vite deri në 109.94 euro, shuma që vajza paguan aktualisht.
- b) Tuition fees. Vajzës time i është dashur t’i paguajë tarifë universitare Universitetit të H. për 10 semestra, sepse aty numërohen 2 semestra Studienkolleg, 2 semestra në degën informatikë mjekësore dhe 6 semestra në fizikë”.

**7.4** Në vijim përgjatë hetimit, subjekti, i pyetur<sup>36</sup> nga Komisioni për banimin dhe shpenzimet e akomodimit të vajzës gjatë periudhës së qëndrimit në shtetin gjerman, ka dhënë shpjegime të detajuara, të cilat janë pasqyruar në analizën financiare të kryer nga Komisioni, të paraqitur në vijim.

Komisioni i kërkoi<sup>37</sup> subjektit shpjegime dhe prova edhe për përfitimet financiare të vajzës së tij gjatë studimeve në këtë shtet dhe kostot e arsimimit të saj, për të cilat ka shpjeguar se nga vërtetimi i Universiteti i H. është shënuar se vajza ka paguar për shpenzimet administrative tarifën e shërbimeve të studentëve, tarifën për përbërjen e bordit studentor dhe tarifën e vona gjatë kësaj kohe, si vijon:

- semestri dimëror 2014 - 2015: 137.30 euro;
- semestri veror 2015: 142.30 euro;
- semestri dimëror 2015 - 2016: 142.30 euro;
- semestri veror 2016: 142.30 euro;
- semestri dimëror 2016 - 2017: 142.30 euro.

Subjekti ka bashkëlidhur me shpjegimet edhe dokumentacionin si vijon:

- kontratë punësimi Au Pair midis B. H., C. dhe J. E., me datë fillimi korrik 2013;
- vërtetim datë 21.4.2020, nga H. B. për E. J.;
- konfirmim pagese për E. J., datë 27.4.2020, H.;
- vërtetim pagese e tarifave semestrare dhe tarifave të shkollimit, datë 14.12.2020, nga Universiteti i M. për E. J.;
- konfirmim i regjistrimit për E. J., datë 3.7.2014, R.;
- certifikatë regjistrimi për E. J., datë 24.11.2015, H.;
- vërtetim banimi për E. J., datë 12.12.2020, nga dr. S. T.-A.;
- përshkrim i shpërblimit neto-bruto për E. J., shkurt 2021;

<sup>35</sup>Pyetësi nr. 3, përgjigjja nr. 4.1.

<sup>36</sup>Pyetësor nr. 3, përgjigjja nr. 4.2.

<sup>37</sup>Pyetësor nr. 3, përgjigjja nr. 4.3.



- deklaratë e fitimeve për E. J., shkurt 2016;
- kontratë e përkohshme midis klinikë “S.” sh.p.k. dhe E. J., datë 2.8.2016; kopje nga Banka e Kursimeve H., ku janë realizuar derdhjet nga punëdhënësi F. A. .

### Hetimi/analiza ligjore-financiare i/e kryer nga Komisioni

**7.5** Nga hetimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Shkencave, Kërkimeve dhe Arteve dhe nga raporti i hartuar nga Zyra Federale për Emigracion<sup>38</sup> rezulton se tarifa e shkollimit prej 1,500 euro në semestër akademik është vendosur për herë të parë në vitin akademik 2017 - 2018. Ndërsa përpara kësaj periudhe kostot e universiteteve përfshinin vetëm kosto administrative të tyre. Për këto të fundit, subjekti ka përcjellë vërtetim nga universiteti ku vajza e tij ndiqte studimet gjatë periudhës 2014 – 2016, të cilat janë konsideruar në analizën financiare të Komisionit.

Nga hetimi i Komisionit në lidhje me shpenzimet e jetesës, sipas faqes zyrtare të DAAD (Shërbimeve të Shkëmbimeve Akademike Gjermane)<sup>39</sup> dhe website-t zyrtar<sup>40</sup> të Shoqatës Kombëtare Gjermane për çështjet e studentëve, rezulton se kostoja mujore e jetesës është 579 euro për vitet 2014 dhe 2015 dhe 819 euro për vitin 2016. Nga këto të dhëna janë zbritur vlerat e qirasë dhe sigurimi shëndetësor, të cilat janë provuar nga subjekti. Në analizën financiare të hartuar për vajzën e subjektit janë pasqyruar të dhënat e sipërcituara.

**7.6** Gjithashtu, vajza e subjektit ka deklaruar edhe detyrime financiare<sup>41</sup> në shtetin gjerman, të cilat janë përfshirë në analizën e Komisionit sipas deklarimit të saj, në shumën totale 470.70 euro.

**7.7** Subjekti ka deklaruar në hetim<sup>42</sup> se gjatë shtatorit të vitit 2017 është larguar për studime dhe punësim edhe djali E. J. .

**7.8** Referuar të dhënave të mësipërme dhe deklarimeve të subjekti, Komisioni hartoi analizën financiare në lidhje me jetesën dhe shpenzimet e vajzës së subjektit në shtetin gjerman, si vijon:

(vlerat në lekë)

Periudha	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Të ardhurat e transferuara nga subjekti	1 471 155	1 376 500	676 350
Të ardhurat e realizuara nga vajza	0	0	349 024
Shpenzime jetike	162 247	956 392	657 412
Shpenzime qiraje sipas deklarimit të subjektit	151 319	268 005	135 946
Pagesa për shpenzime administrative për universitetin	19 237	39 175	38 498
Shpenzime për sigurimin shëndetësor	33 206	130 492	128 236
Shpenzime të vajzës E.J. në shtetin gjerman të deklaruar prej saj	-	14 449	68 865
<b>Rezultati financiar</b>	<i>1 105 146</i>	<i>(32 013)</i>	<i>(3 583)</i>

<sup>38</sup>Shihni [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/11a\\_germany\\_international\\_students\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/11a_germany_international_students_en.pdf) (faqja 29, pika 4.1.5) dhe <https://mök.baden-wuerttemberg.de/de/hochschulen-studium/studienfinanzierung/gebuehren-fuer-internationale-studierende-und-zoeitstudium/tuition-fees-for-international-students/>

<sup>39</sup>Shihni <https://www.daad.de/en/study-and-research-in-germany/plan-your-studies/costs-of-education-and-living/>

<sup>40</sup>Shihni <https://www.studentenwerke.de/en/content/student-halls-residence;>

<https://www.studentenwerke.de/en/content/accommodation-and-studies>

<sup>41</sup> Detyrim ndaj kompanisë “\*\*\*\*” për llogari të numrit celular të marrë me kontratë, periudha 11 shtator 2015 për 24 muaj. Shuma mujore për t’u paguar 34.99 euro, koha e mbetur: 11 muaj. Mbetur për t’u paguar 34.99 x 11 muaj=384.89 euro.

Detyrim një herë në dy javë deri në datën 31.12.2016, ndaj palestrës “\*\*\*\*Fitness”. Shuma për t’u paguar çdo dy javë: 16.22 euro. Koha e mbetur për t’u paguar është 11 javë 5.5 herë. Mbetur për t’u paguar 16.22 euro x 5.5 jave=89.21 euro.

<sup>42</sup>Shihni pyetësorin standard dhe DIPP-në e viteve 2017 e 2018.

Në konkluzion të sa më sipër, në analizë të dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit, si dhe hetimit në faqen zyrtare të Univerisitetit M., Komisioni çmoi se deklarimi i subjektit dhe vajzës së tij përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga “Credins Bank”<sup>43</sup> dhe me dokumentacionin e përcjellë nga subjekti për shpenzimet dhe të ardhurat në shtetin gjerman. Derdhjet e vlerave në euro, të cilat më pas janë transferuar drejt vajzës së tij, janë bërë derdhje *cash* në llogarinë e tij në “Credins Bank”.

## 7.9 Deklarimi i të ardhurave të bashkëshortes

**7.9.1** Paga dhe të ardhura nga bashkëshortja V. J. J., në total në shumën 7,388,176 lekë, të detajuara si vijon:

- i) Paga e marrë për periudhën janar 1994 – korrik 1994, në detyrën e ndihmës gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Shuma: 0 lekë. Të ardhura të realizuara përpara martesës.
- ii) Paga e marrë për periudhën 11.7.1994 – shkurt 2000, në detyrën e juristes në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare. Shuma: 803.443 lekë. Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting*<sup>44</sup> vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017, nga Posta Shqiptare, për të ardhurat e realizuara nga shtetasja V. Sh. (J.), gjatë periudhës 11.7.1994 – shkurt 2000, në shumën totale 803,443 lekë.
- iii) Pagë për 1 vit, e marrë me vendim gjykate për largim të padrejtë nga puna në “\*\*\*\*” sh.a. Shuma: 264,000 lekë. Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting*<sup>45</sup> shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, lëshuar nga Zyra e Përmbartimit Tiranë, në të cilën konstatohet se në arkivën e saj ndodhet dosja përmbartimore me kreditor shtetasen V. J. (Sh.) dhe debitor subjekti “\*\*\*\*” sh.a. Bashkëlidhur ndodhet kopje e dosjes përmbartimore, e cila përmban dokumentacionin e plotë ligjor për përfitimin e shumës 264,000 lekë sipas vendimeve të gjykatave, me palë paditëse V. J. dhe palë të paditur “\*\*\*\*” sh.a.

***Të ardhurat e mësipërme të paraqitura në pikën ii) dhe iii) janë konsideruar në analizën financiare të subjektit.***

- iv) Të ardhura nga aktiviteti i punës pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë, për 12 vjet punë, për vitet 2005 – fund i vitit 2016. Shuma totale është 6,320,733 lekë. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Lidhur me të ardhurat nga ky aktivitet, bazë mbeten deklaratat periodike e bëra ndër vite, pasi ato pasqyrojnë të ardhurat de facto për çdo vit. Sipas sqarimeve të bashkëshortes, kjo ndodh për faktin se përpara organeve tatimore deklarimi i xhiros bëhet për vlerën e të ardhurave mbi bazën e kontratave dhe premtimeve të klientëve. Faktikisht, punët e marra përsipër në disa raste kalojnë në disa vite dhe për këtë shkak vjelja e detyrimeve nga klientët bëhet në vite të ndryshme, pavarësisht se për to janë bërë deklarime dhe janë paguar taksat sipas legjislacionit tatimor*”.

**7.9.2** Referuar të dhënave të administruara gjatë hetimit administrativ për të ardhurat e bashkëshortes nga ushtrimi i profesionit të lirë avokati, rezulton si vijon:

- QKB-ja<sup>46</sup> konfirmon se shtetasja V. J. J. rezulton e regjistruar si person fizik me vendimin datë 15.9.2004, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me NIPT\*\*\*, dhe me fushë veprimtarie “avokat”, me datë regjistrimi 1.1.2005.

<sup>43</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 4.12.2020, të “Credins Bank”.

<sup>44</sup>Shihni aneksin nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>45</sup>Shihni aneksin nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>46</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 1.12.2020, të QKB-së në dosjen e Komisionit.

- DPT-ja<sup>47</sup> konfirmon se shtetasja V. J. J. rezulton e regjistruar me subjekt tatimor në emër të saj si “V. J. person fizik” dhe përcjell të dhënat e paraqitura në tabelën vijuese. Gjithashtu, Komisioni, duke u mbështetur në praktikën e tij dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>48</sup>, ka llogaritur me 80% marzhin e fitimit për vitet 2005 – 2008, për të cilat konfirmohet qarkullimi vjetor nga organet inspektuese, por nuk deklarohet fitimi *neto* i këtyre viteve, i cili do të merrej në konsideratë. Në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni është marrë në konsideratë vlera më e ulët midis vlerës së deklaruar nga subjekti në deklaratimet e tij vjetore dhe vlerës që rezulton nga llogaritjet e mësipërme ose nga vërtetimet e institucioneve inspektuese.

Periudha	Të ardhurat e deklaruar <i>bruto</i> nga dokumentacioni ligjor	Fitimi <i>neto</i> sipas dokumentacionit ligjor ose nga praktika e Komisionit	Deklarimi i subjektit në DIPP-të periodike	Vlerat e konsideruar në analizë
2005	1,500,000	1,200,000	600,000	600,000
2006	2,666,666	2,133,333	650,000	650,000
2007	2,000,000-3,000,000	1,600,000	650,000	650,000
2008	3,000,000-4,000,000	2,400,000	830,000	830,000
2009	2,170,100	621,232	970,000	621,232
2010	1,770,000	840,488	750,000	750,000
2011	2,000,000	830,000	450,000	450,000
2012	253,181	(107,000)	372,041	(107,000)
2013	553,000	81,413	430,000	81,413
2014	327,499	245,942	245,942	245,942
2015	275,016	13,724	320,000	13,724
2016	400,165	16,177	400,165	16,177
		<b>9,875,309</b>	<b>6,668,148</b>	<b>4,801,488</b>

**7.9.3** Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se bashkëshortja V. J. rezulton debitore në shumën 97,895 lekë me Bashkinë Tiranë: për vitin 2012 në vlerën 70,483 lekë; dhe për vitin 2013 në vlerën 27,412.5 lekë, dhe se për shlyerjen e kësaj shume është mbajtur një aktmarrëveshje për mënyrën e shlyerjes. Ndërsa në deklaratën e vjetore të vitit 2017 ka deklaruar shlyerjen totale të saj.

Komisioni ka konsideruar në analizën financiare totalin e të ardhurave të bashkëshortes prej 4,801,488 lekësh. Sa më sipër, Komisioni ka marrë në konsideratë në analizën financiare të ardhurat e konfirmuara nga organet tatimore dhe ato të njohura nga praktika e ndjekur për raste të ngjashme.

**7.9.4** Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me të ardhurat dhe përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për aktivitetin e bashkëshortes, ka shpjeguar: “*Po kështu, ashtu siç kam deklaruar, nga bashkëshortja ime më është thënë që ka arkëtuar detyrime të prapambetura, dhe për këtë shkak ka dhe pasaktësi në deklaratimet e mia dhe të ardhurat e deklaruar në tatime.*

*Aktiviteti i bashkëshortes sime si avokate, ka edhe një specifikë, të cilën në përditshmërinë tonë dhe në praktikë e hasim shpesh. Arkëtimet kryesisht nga avokatët për një pjesë të shërbimeve të tyre kryhen edhe me mbarimin e çështjes së marrë përsipër apo të suksesit në realizimin e saj. Unë kam deklaruar që bashkëshortja ka realizuar arkëtime të mëvonshme për shërbime, të cilat i ka deklaruar në periudhat e mëpërparshme. Aktiviteti i saj si person fizik, ku pasuria e personit fizik njësohet me atë të personale, kërkon një analizë pak më të detajuar.*

*Fitimi i deklaruar në aktivitetin e avokatit nuk mund të përfaqësojë realisht paratë e arkëtuara nga ai. Kjo për shkak se sipas specialistëve të fushës ekonomike cash flow (rrjedhja e parasë) ndryshon*

<sup>47</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 1.12.2020, të DPT-së në dosjen e Komisionit; shkresën nr. \*\*\*prot., datë 7.9.2017, të Drejtorisë Rajonale Tiranë, aneks nr. 32, dosja ILDKPKI; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2017, të Bashkisë Tiranë, aneks nr. 34, dosja ILDKPKI; dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, të Bashkisë Tiranë, provë bashkëlidhur pyetësorit standard.

<sup>48</sup>Shihni vendimin nr. 26 regjistër (JR), nr. 12 i vendimit, datë 6.7.2020, të KPA-së, pika 82, subjekti P. Gj. .

nga fitimi kontabël i deklaruar. Për të dhënë një shembull, nëse gjatë një viti deklarohet një shërbim dhe shuma e rënë dakord për këtë shërbim deklarohet si e ardhur, por arkëtimi i këtij shërbimi kryhet në vitin pasardhës, jemi përballë faktit që në vitin e deklarimit të të ardhurës kemi një fitim kontabël më të madh, por që realisht kemi arkëtime në para më pak dhe në vitin pasardhës, edhe pse nuk kemi të ardhura dhe mund të rezultojmë me humbje, realisht kemi arkëtuar para. Për financierët ky term dhe kjo logjikë ekonomike është e njohur dhe e pranuar. Në rastin e aktiviteteve tregtare dhe kryesisht profesionet e lira, avokatët me status 'person fizik' ku pasuria e shoqërisë është e njësuar me pasurinë individuale është e rëndësishme që të bëhet një analizë më e detajuar e arkëtimeve nga biznesi se sa referimi në deklarimin e fitimit. Fakti që vështirëson në rastin e bashkëshortes sime është mungesa e bilanceve për shkak se si biznes i vogël nuk ka pas detyrim ligjor dorëzimin e pasqyrave financiare të plotë ku të evidentohen edhe të gjitha pasqyrat financiare, përfshi këtu edhe pasqyrën e cash flowt.

Bashkëshortja ime ka pasur, për sa ka gjetur, dy arkëtime të mëvonshme për dy angazhime të saj në shërbime.

Në rastin e parë me kontratën e punës të datës 13.10.2009, ajo ka lidhur një kontratë pune me shtetasin S. V., për një shërbim ku është deklaruar si e ardhur nëpërmjet faturës nr. \*\*\*, datë 13.10.2009, në vlerën 303,000 lekë. Pagesa e këtij shërbimi ishte parashikuar të bëhej me këste. Sipas vërtetimit të pagesës, datë 31.7.2015, rezulton që shtetasi S. V. të ketë paguar këstin e parë në kohën e lidhjes së kontratës dhe pagesën e këstit të dytë, datë 31.7.2015, në shumën 250,000 lekë. Në këtë rast, edhe pse unë kam deklaruar një fitim prej 320,000 lekësh në DPV-në e vitit 2015 nga aktiviteti i bashkëshortes, duke iu referuar deklaramëve të saj me shumë gjasë ajo i është referuar edhe këtij arkëtimi të kryer në vitin 2015, në shumën 250,000 lekë. Në këtë vit nga ana juaj nuk është marrë në konsideratë deklarimi im, por deklarimi në tatime ku rezulton një fitim në shumën 13,724 lekë. Në fakt në këtë vit janë arkëtuar edhe 250,000 lekë.

Në rastin e dytë bashkëshortja ka pasur një kontratë pune në datën 15.9.2009 me shtetasin N. L. . Sipas kontratës që në fillim ishte parashikuar që pagesa do të bëhej në përfundim dhe me realizim e procedurës së pajisjes me certifikatë pronësie, proces ky që u finalizua në vitin 2016. Fatura tatimore e lëshuar që në momentin e lidhjes së kontratës ka nr. \*\*\* dhe datë 15.9.2009, me vlerë 400,000 lekë. Vërtetimi i pagesës është kryer në datën 9.12.2016.

Me deklaratat noteriale dhe akteve bashkëlidhur tyre, mendoj se sqarohet procedura që ka ndodhur në aktivitetin e avokatisë.

Të paktën në këto dy raste, fitimi i deklaruar në tatime nuk përputhet me arkëtimet e bashkëshortes dhe që për familjen tona kanë qenë likuiditete të përfituara”.

Subjekti ka përcjellë me shpjegimet:

- deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 5.7.2021, bashkë me dokumentacionin bashkëlidhur saj;
- deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 5.7.2021, bashkë me dokumentacionin bashkëlidhur saj.

**7.9.5** Komisioni, bazuar në përmbajtjen e dokumentacionit të hetuar, si dhe shpjegimeve të situatës së sqaruar më lart, subjekti shpjegon ndryshimin e gjendjes në arkë me fitimin kontabël të deklaruar. Është e vërtetë që gjendja cash mund të mos jetë e njëjtë sa fitimi i realizuar atë vit, por fitimi i atij viti është vlere që është tatuar dhe përfshin edhe vlerën e gjendjes së arkëtuar gjatë vitit pasardhës, por deklarimi i saj bëhet në vitin që është lidhur kontrata e punës dhe është rënë dakord për vlerën e saj. Pikërisht në këtë vit regjistrohet edhe si e ardhur kjo vlerë dhe tatohet në po këtë vit (në vitin e nënshkrimit të kontratës). Ndërsa arkëtimi i saj mund të ndodhi më vonë dhe kjo ndryshon vetëm gjendjen e arkës (cash) të veprimtarisë ekonomike.

Trupi gjykues, nisur nga fakti se ushtrimi i profesionit të avokatit është një aktivitet që ka një marzh të lartë fitimi, ka konstatuar se është i mundur krijimi dhe realizimi i të ardhurave nga bashkëshortja

dhe, për pasojë, trupi gjykues çmon bazuar në arsyetimin e mësipërm për këtë pasuri se subjekti ka kryer deklaram të saktë.

## 8. Gjetje të tjera

**8.1** Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“Dhënë borxh kunatit A. Sh., i cili emigroi në SHBA, me familjen, shumën 1,500,000 lekë. Borxhi pa afat, sipas mundësisë së tij për shlyerje”*.

Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar huan e dhënë te kunati i tij në deklaratën e pasurisë Vetting.

**8.1.1** Gjatë hetimit, subjekti<sup>49</sup> ka shpjeguar: *“Deri në momentin e ardhjes së pyetësorit të dytë, kam qenë i bindur se si këtë dhënie borxhi kunatit, ashtu edhe për borxhin e marrë nga vëllai S. J., i kisha deklaruar edhe në deklaratën Vetting. Pas verifikimit të bërë konstatova se nuk e kam bërë një deklaram të tillë në deklaratën Vetting për të dy rastet që kanë të bëjnë me marrëdhënie borxhi. Për mosshënimin e këtij veprimi në deklaratën Vetting e them me sinqeritet dhe përgjegjësi morale se mosshënimi i dhënies borxh kunatit A.Sh., si dhe i marrjes së borxhit vëllait, sipas porosisë së nipit, kanë në themel të tyre vetëm harresën e të mosshënuarit, pasi për të dy veprimet e kryera të cilat ishin deklaruar në një deklaramë periodike, në asnjë rrethanë nuk mund të mendohet se mosdeklarami i tyre në deklaratën Vetting të kishte ndonjë qëllim tjetër. Për këtë harresë, në deklaramin e dhënies dhe marrjes së borxheve në deklaratën Vetting, kërkoj mirëkuptimin tuaj dhe ndjesë nga ana morale, pasi duke qenë se, si dhënia nga ana ime e borxhit kunatit, ashtu edhe marrja nga unë më vonë e borxhit nga vëllai, janë deklaruar në deklaramat periodike përkatëse në vitet 2009 e 2015, kjo pasaktësi në deklaram ka ardhur si rezultat i harresës njerëzore, dhe për këtë qëndrimi im është tepër reflektues. Në vijim, sqarojmë se borxhin e dhënë kunatit A. Sh. në vitin 2009, akoma deri më sot nuk e kam marrë, pasi ai familjarisht nuk ka pasur mundësi financiare për të kthyer shumën e marrë apo ndonjë këst të kësaj shume prej 1,500,000 lekë. Për këtë borxh, meqenëse në kohën e dhënies së tyre nuk kishim hartuar ndonjë dokument apo deklaramë edhe për shkak të kohës së pakët që pati në dispozicion gjatë ikjes familjarisht me lotari për në SHBA për këtë vetëm me datë 24.12.2019, përpara noteres kemi përpiluar një deklaramë noteriale.*

*Meqenëse familjarisht kunati erdhi në Shqipëri për vitin e ri 2019, në datën 24.12.2019 hartuam përpara noteres një deklaramë noteriale ‘për njohje detyrimi’, me të cilën, përveç njohjes së detyrimit, vendosëm edhe një afat 3-vjeçar për kthimin e plotë të shumës. Deri aktualisht nga ana e kunatit nuk kam marrë asnjë lekë nga shuma prej 1,500,000 lekësh të dhëna borxh në janar të vitit 2009”*.

Subjekti ka përcjellë me shpjegimet, si dokument provues për dhënien e huas dhe mosshlyerjen ende të tij, deklaramë noteriale “për njohje detyrimi”, nr. \*\*\*, datë 24.12.2019, të deklaruesve A. Sh., V. dhe Isa Jata.

**8.2** Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Marrë borxh si mbështetje për studimet e vajzës në Gjermani, nga vëllai S.J., shumën 500.000 lekë, borxhi i marrë pa afat, sipas porosisë së nipit M. J. në New Jersey, SHBA”*.

Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting marrjen e huas nga vëllai i tij shtetasi M.J. në vitin 2015.

**8.2.1** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur gjatë<sup>50</sup> hetimit, ka sqaruar se: *“[...] kam deklaruar se e kam kthyer të plotë të gjithë shumën njëherësh në datën 5.3.2019. Deklaramin e kthimit të kësaj shume e kam deklaruar në deklaramë periodike vjetore të vitit 2018, të bërë në datën 25.3.2019, dhe në*

<sup>49</sup>Shihni përgjigjen nr. 2 në pyetësorin nr. 2.

<sup>50</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, përgjigja nr. 3.1.

*kthim përgjigjen e pyetësorit nr. 1. Këtë shumë e ktheva të plotë edhe pse për të nuk kishte ndonjë afat të përcaktuar për kthimin e saj, por u krijua mundësia për të bërë likuidimin e shumës. Për këtë veprim, nga ana e vëllait S. J. u përpilua një deklaratë me shkrim dore të tij, me të cilën deklaroi marrjen prej meje Isa Jata, të shumës së plotë prej 500,000 lekësh”.*

**8.2.2** Subjekti ka përcjellë me shpjegimet deklaratën noteriale të datës 22.4.2020, të deklaruesve A. J. dhe M. J., të cilët deklarojnë se huaja është kthyer në vitin 2019 dhe deklaratën e thjeshtë (jo noteriale) të datës 5.3.2019, në të cilën shtetasi S. J. deklaroi se në datën 5.3.2019 është kthyer huaja nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, rezultoi se subjekti e ka deklaruar kthimin e saj në DIPP-në e vitit 2018.

Në lidhje me aftësinë huadhënëse të shtetasve M. dhe S. J., subjekti ka vijuar me shpjegimin<sup>51</sup> se: *“Nga ana e nipit M. J. (djali i vëllait tim S. R. J. ), lidhur me faktin e borxhit të marrë nga unë, vëllait S. J. , me porosi të tij, janë bërë sqarime si më poshtë: (a) fillimisht me deklaratën e datës 22.4.2020 u konfirmua përpara noterit publik në SHBA fakti i lënies së shumës pranë vëllait S. J., kur ishte familjarisht me pushime në vitin 2015; (b) në datën 2.12.2020 më dërgoi të dhënat e nisura drejt nipit M. J., nga ekonomisti i firmës së tij i quajtur A. N. Me anë të kësaj shkrese në gjuhë angleze konfirmohen të ardhurat dhe taksat e paguara nga M. e A. J., për vitet 2014 e 2015, bashkëlidhur të cilave gjendet edhe specimentet e detajuara të taksave për këto dy vite”.*

**8.2.3** Subjekti ka përcjellë në Komision me shpjegimet e tij vërtetimin e ardhurave dhe taksat e realizuara nga shtetasit M. dhe A. J. me aktivitet në SHBA, të cilat janë të konfirmuara nga zyra e tyre kontabiliste dhe të provuara me kopje të deklaratave periodike të viteve 2014 - 2015. Nga analiza e këtij dokumentacioni, rezultoi si vijon:

- të ardhurat e deklaruara të vitit 2014 janë 57,200 USD dhe taksat e shlyera 7,393 USD;
- të ardhurat e deklaruara të vitit 2015 janë 72,687 USD dhe taksat e shlyera 9,750.55 USD;
- gjithashtu, përcillet edhe kopje e certifikatës së biznesit (*certificate of incorporation*, pjesë e kërkesave ligjore të regjistrimit të bizneseve) për “*Vila farms dayri*” INC, me përfaqësues ligjor shtetasin M. J. .

**8.2.4** Nga përmbajta dokumentacionit të lartpërmendur rezultoi se në formularin e deklarimit të të ardhurave për vitet 2014 - 2015, personi i lidhur ka deklaruar edhe adresën e banimit dhe përbërjen familjare. Përkatësisht, në vitet 2014 dhe 2015 ai jetonte në adresën: \*\*\* \*\*\* *Road, N.H., NJ* \*\*\*, \*\*\* dhe familja e tij ishte e përbërë nga 4 anëtarë (ai, bashkëshortja dhe dy fëmijët minorene). Komisioni, mbështetur në informacionin e dokumentacionit të përcjellë nga subjekti dhe duke iu referuar të dhënave statistikore të mbledhura nga faqet zyrtare të statistikave<sup>52</sup> të vendit ku jeton dhe është shtetas i saj huadhënësi, hartoi analizën financiare, si më poshtë paraqitur:

<b>Analiza financiare</b>	<b>1.1.2015 – 1.8.2015</b>
Të ardhurat familjare të realizuara nga M. J. dhe të provuara me dokumentacion	6,064,790 lekë
Shpenzimet jetike për 4 persona <sup>53</sup>	4,623,880 lekë
<b>Rezultati financiar</b>	1,440,910 lekë

**8.2.5** Në konkluzion të analizës financiare të kryer nga Komisioni për aftësinë huadhënëse të personit të lidhur, shtetasit M. J., Komisioni çmoi se huadhënësi ka pasur mundësi të japë hua me

<sup>51</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, përgjigjja nr. 3.2.

<sup>52</sup><https://www.census.gov/quickfacts/northhaledonboroughnewjersey>

<sup>53</sup><https://www.census.gov/quickfacts/northhaledonboroughnewjersey>

të ardhura të ligjshme vlerën e deklaruar prej 500,000 lekësh subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, referuar vendimit nr. 15, datë 17.7.2019, të KPA-së, i cili orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, sipas paragrafit 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, në të cilën Kolegji ka çmuar se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur të cilët nuk janë subjekt deklarues.

**8.2.6** Trupi gjykues çmon se në vlerësim të të gjitha provave dhe fakteve të administruara nga hetimi administrativ konstatohen pasaktësi në mosdeklarimin e kësaj huaje në deklaratën *Vetting*. Në analizë të DIPP-ve periodike konstatohet se subjekti ka deklaruar në mënyrë të plotë huan e marrë dhe shlyerjen e saj, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit në përputhje me nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka dhënë shpjegime të plota për burimin e ligjshëm të kësaj huaje.

**9. DPSHTRR<sup>54</sup>-ja ka konfirmuar se subjekti ka të regjistruar automjetin me targa \*\*\*.** Gjithashtu, subjekti e deklaroi këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2019, si dhe mënyrën e pagesës: “[...] me kontratë qiraje leasing nëpërmjet ‘Credins Bank’ u bë pagesë e menjëhershme 6,000 euro + 165 euro, 1 % interes i menjëhershëm, si dhe 462 euro sigurimi kasko i mjetit. Gjithsej: 6,627 euro...”, dhe përcjell me pyetësorin standard kontratën e blerjes me leasing nga “Credins Bank” për automjetin tip “Volkswagen Jetta”, të blerë me kontratën e shitblerjes datë 22.7.2019, me vlerë 16,500 euro. Subjekti ka lidhur edhe kontratë qiraje financiare me “Credins Bank”, për një afat 5-vjeçar, në bazë të së cilës ka parapaguar vlerën 7,000 euro (jo 6,000 euro siç deklaroi në pyetësor) për automjetin dhe pjesa e mbetur është shlyer me leasing. Në lidhje me pjesën e parapaguar prej të derdhur *cash* në datën 24.7.2019, subjekti ka shpjeguar se: “[...] konstatohet se derdhja në *cash* është bërë pasi më parë kam tërhequr nga llogaria ime shumë prej 815,500 lekësh.... Për vlerën e derdhur prej 7,000 euro, veç shumës së tërhequr nga banka prej 815,500 lekësh, shtova vlerën prej 37,500 lekësh që kisha me vete, duke bërë që përkundrejt kursit ditor të euros 121.75 arrita të blija 7,000 euro, duke i derdhur në llogarinë time pranë ‘Credins Bank’ [...]”.

Nga hetimi dhe verifikimi i llogarive bankare të subjektit në analizën krahasimore, si dhe deklaratimet e subjektit, rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”<sup>55</sup>.

**10.** Nga kërkimi në faqen *online* të ASHK-së rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në të dhënat nga sistemi digjital, kishte në bashkëpronësi me shtetasin F. B. T. pasurinë e llojit “arë”, me sip. 1000 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Bërxull. Prona dukej se ishte fituar në vitin 2008 me kontratë shitjeje, me vlerë të paguar 401,000 lekë. Komisioni konstatoi se kjo pasuri nuk ishte deklaruar nga subjekti në asnjë prej deklaratimeve të interesave private periodike dhe as në deklaratën *Vetting*. Referuar dokumentacionit të gjeneruar nga sistemi IPS rezultoi se bashkëshortja e subjektit ka qenë përfaqësuesja ligjore e palës blerëse, shtetasve F.B.T. dhe A. T., dhe jo subjekti i rivlerësimit.

**10.1** Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit<sup>56</sup> në lidhje me këtë pasuri, për të cilën deklaroi se: “[...] në datën 14.4.2021, nëpërmjet e-Albania drejtova kërkesë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ku pasi bëra të ditur situatën kërkova informacion të detajuar. Në përgjigje të kësaj kërkesë Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë ktheu përgjigje zyrtare, si dhe ka bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin ligjor të gjendur në arkivë që ka të bëjë me këtë pronë, nga e cila rezultoi se: ‘gjatë hedhjes në sistem ishte hedhur gabim ID e A. T. dhe kemi proceduar me korrigjimin e gabimit, duke e zëvendësuar personat e sipërpërmendur’”.

<sup>54</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2020, të DPSHTRR-së.

<sup>55</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 4.12.2020, të “Credins Bank”.

<sup>56</sup>Pyetësori nr. 3, përgjigjja nr. 6.

Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të tij dokumentacionin, si vijon:

- kërkesën për informacion mbi pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, aplikuar *online* në *e-Albania*, në datën 11.4.2021, drejtuar ASHK-së, Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë;
- përgjigjen datë 12.4.2021, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë;
- aplikimin *online*, datë 13.4.2021, në faqen zyrtare të ASHK-së;
- përgjigjen e ardhur në *e-Albania*, datë 20.4.2021, nga ASHK-ja.

Nga verifikimi i kryer nga Komisioni në sistemin IPS të pasurive të paluajtshme, konstatohet se pas veprimeve të mësipërme të subjektit nuk rezulton më bashkëpronar në këtë pasuri.

**10.2** Nga korrespondenca e Komisionit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës<sup>57</sup> rezultoi se emri i subjektit të rivlerësimit si bashkëpronar në këtë pasuri është një gabim material dhe subjekti i rivlerësimit nuk rezulton bashkëpronar në këtë pasuri. Në lidhje me kërkesën se si është bërë regjistrimi në faqen elektronike të zyrës në emër të subjektit të rivlerësimit, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Vorë-Kamëz sqaron se pasuritë janë hedhur në sistem nga grupi i projektit të përmirësimit-përditësimit, ku në lidhje me pasurinë nr. \*\*\*, në vol. \*\*\*, f. \*\*\* është pasqyruar gabimisht në marrjen e të dhënave, për sa i përket emrave të pronarëve. Pas verifikimit të kontratës së shitjes, subjekti i rivlerësimit nuk rezultonte bashkëpronar për këtë pasuri, dhe për këtë arsye zyra mundësoi korrigjimet përkatëse. Bashkëlidhur përgjigjes dërgohet edhe praktika e regjistrimit të pasurisë sa më sipër, por jo urdhri i korrigjimit i drejtorit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë. Komisioni iu drejtua disa herë me shkresë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë, lidhur me depozitimimin në Komision të aktit administrativ, mbi bazën e të cilit është bërë i mundur korrigjimi në sistem i bashkëpronësisë të subjektit, por nga kjo agjenci nuk u përcoll urdhri i korrigjimit. Në zbatim të nenit 16, pika 2 e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, të dhënat kadastrale si digjitale dhe fizike kryhen me urdhër të regjistruarit ose drejtorit të Drejtorisë Vendore.

**10.3** Sa më sipër, trupi gjykues çmon se nuk jemi para një pasurie të fshehur nga subjekti i rivlerësimit apo personave të lidhur. Në aktet e administruara rezulton e qartë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka qenë përfaqësuese me prokurë e palës blerëse. Pavarësisht konstatimit të trupit gjykues se procedurat e regjistrimit apo korrigjimit të gabimit të bërë në sistem nuk janë vënë të plota në dispozicion, aktet e fitimit të pronësisë japin të qartë se subjekti nuk gëzon asnjë të drejtë reale mbi këtë pronë dhe, për rrjedhojë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë konform dispozitave ligjore në fuqi.

**11. Nga verifikimi i përmbajtjes së shkresës kthim përgjigje nga Ministria e Drejtësisë<sup>58</sup>, regjistri i noterëve,** dërgohet informacion mbi veprime noteriale në të cilat ka qenë palë bashkëshortja e subjektit V. J. dhe nuk janë deklaruar nga subjekti deri në deklaratën *Vetting*.

**11.1** Në analizë të përmbajtjes së këtyre akteve ka rezultuar se janë akte të hartuara në ushtrim të profesionit të avokatisë nga bashkëshortja dhe jo si individ. Komisioni iu drejtuar me shkresë<sup>59</sup> noterëve, tek të cilët rezultojnë të jenë hartuar këto akte noteriale, të cilët në përgjigje të tyre informojnë se shtetasja V. J. është në cilësinë e përfaqësueses ligjore të palëve që kanë kryer veprime juridike të ndryshme. Gjithashtu, është përcjellë informacion edhe për dy deklaratat noteriale, të datës 14.3.2019, nënshkruar pranë noterit R. H. për heqje dorë nga pronësia dhe në datën 16.4.2018 pranë noterit L.M., nënshkruar kontratë shitjeje ose dhurim-kalim pasurie të paluajtshme, me palë S.J. (vjehtëra e subjektit), shtetasit V. J., e F. Sh.(kunati i subjektit) dhe shtetasi T. N.

<sup>57</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2021; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 1.6.2021, e ASHK-së.

<sup>58</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2020, të Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>59</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021, noter M. Ç.; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2021, noter R. M.; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2021, noter L. G.; shkresë nr.\*\*\*prot., datë 15.4.2021, noter P.B.B.; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2021, noter M. Sh. .



**11.2** Në lidhje me aktet noteriale të lartpërmendur në DIPP-në e vitit 2018, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Me dëshminë e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 11.4.2018, në Fier, pranë noterit L. M. është çelur dëshmia e trashëgimisë kërkuar nga mamaja ime S. Sh. . Në këtë dëshmi është pranuar kërkesa për trashëgimlënësin J. Sh. (babai im), duke përcaktuar si trashëgimtar të vetëm ligjor të radhës së parë: 1-S.Sh., 2-Sh.Sh., 3- A. Sh., 4-V. Sh., 5- S. Sh. 6-M. Sh. dhe 7- F. Sh., secilit përfitues me nga 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore. Me deklaratat noteriale të datës 6.3.2019, me nr. \*\*\*, dhe nr. \*\*\*, para noteres R.H., në Fier, nga unë V.J. . është hequr dorë, përkatësisht: 1-nga pasuria e paluajtshme ‘tokë arë’, e ndodhur në NB A., sip. 3317 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, 2-nga pasuria e paluajtshme ‘apartament banimi’, i ndodhur në Fier, me sip. 78 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*”.*

## **ANALIZA FINANCIARE**

**1.** Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike vjetore ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet, nga përlllogaritja e tyre është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të kursyera, me të ardhurat nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**2.** Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2010, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i subjektit në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar, ka rezultuar fillimisht me një bilanc të përgjithshëm në vlerë negative prej **2,942,729 lekësh** (përkatësisht në vitet 2009 - 2010 dhe 2013 - 2016), për të cilën subjektit iu kalua barra e provës.

**3.** Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor, të cilat janë përcjellë pas kalimit të barrës së provës, si dhe analizoi qëndrimin e tij në seancën dëgjimore për rezultatin e analizës financiare të lidhur kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve ditore vajte-ardhje në Kosovë, llogaritjen e shpenzimeve jetike për vitin 2009 për vajzën vetëm pas datës së lindjes së saj apo dhe për 36 ditë të qëndrimit të subjektit jashtë territorit shqiptar, për të cilat janë llogaritur shpenzime qëndrimi sipas metodologjisë së analizës financiare të Komisionit dhe zbritjes së shpenzimeve të deklaruara në vitin 2014, në përputhje me deklarin DIPP-në e vitit 2014, duke zbritur gjendjen *cash* të atij viti.

Në përfundim të sa më sipër, bazuar në arsyetimet dhe qëndrimet e mbajtura nga trupi gjykues, u arrit në konkluzionin se rezultati i analizës financiare të subjektit është në vlerën negative prej **1,174,117 lekësh**.

Në lidhje me problematikat e analizës financiare, trupi gjykues çmon se këto pasaktësi dhe këto mangësi të burimeve financiare – për një total të akumuluar në shumën prej 1,174,117 lekësh (me bilanc negativ në analizën e viteve 2014 - 2016) – nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

### **4. Konkluzione përfundimtare për kriterin e pasurisë**

Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet marrë në konsideratë, si vijon:

Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Për sa më sipër janë konstatimet, Komisioni çmon t'i vlerësojë në vendimmarrjen e tij në respektim të ligjit, të qëllimit të ligjit dhe respektimit të parimit të proporcionalitetit, si një nga parimet më të rëndësishme në dhënien e një mase disiplinore.

Lidhur me faktin se a ka pasaktësi nga subjekti në deklaratimet periodike të sipërcituara dhe cila është pasoja që ka ardhur në drejtim të realizimit të procesit të rivlerësimit të pasurisë për të, trupi gjykues çmon se për subjektin e rivlerësimit padyshim qëndron detyrimi që të deklarojë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9049/2003. Për këtë çështje, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur qëndrimin e tij.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, lidhur me këtë, në vendimin nr. 20/2019, në pikat 55 dhe 56 të tij, përcakton: *“[...] ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhin ata mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar [...]. Në këndvështrim të kuadrit ligjor, subjekti ka detyrë të deklarojë duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurore e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklarimeve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues [...]”*.

Në këtë analizë, Komisioni çmon se referuar vendimmarrjes së deritanishme apo edhe qëndrimeve të konsoliduara të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>60</sup>, pasaktësitë në deklarime nuk mund të konsiderohen si shkelje të asaj mase, të cilat mund të shërbejnë si bazë ligjore për marrjen e masës së shkarkimit.

Në vendimin nr. 5/2019 përcaktohet se: *“[...] Në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave ligjore si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, faqja 13 nga 37, vlerëson se sipas ligjit nr. 84/2016, pamjaftueshmëria e deklarimit për deklaratimet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklaratim të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaratim të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit [...]”*.

Në vendimin nr. 19/2019, në pikën 22.14 dhe 22.15 të tij përcaktohet se: *“[...] trupi gjykues vëren se objekt i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, janë edhe deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja që, mbështetur në ligjin nr. 84/2016, nëse subjekti ka bërë deklaratim të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaratim të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin e faqes 11 nga 18 subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga*

<sup>60</sup> Vendimet nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018; nr. 5/2019 (JR), datë 18.2.2019; nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018; dhe nr. 5/2019 (JR), datë 18.2.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

*Komisioni dhe Kolegji. Këto deklarata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Kontrolli i deklaratës Vetting dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, vlerësohet si mjet që shërben gjatë procesit të rivlerësimit për kriterin pasuror, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Kjo merr vlerë specifike, sidomos në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri. Kjo analizë është në përputhje edhe me vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin nënvizohet se organet e reja kushtetuese të procesit të rivlerësimit nuk kanë zhbërë sistemin ekzistues të kontrollit dhe vlerësimit të funksionarëve publikë. Po në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese mban qëndrimin se kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të [...]”.*

Në bazë të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 5, të nenit 33, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në analizë të konstatimeve si më sipër, gjatë vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi se pasaktësitë dhe mospërputhja e qëndrimeve gjatë hetimit krahasuar me përputhshmërinë ndër vite të DIPP-ve me deklaratën Vetting, në deklaratimet e likuideteve cash dhe qëndrimi jo konsistent gjatë hetimit, si dhe konstatimet si më sipër lidhur me balancat negative në shuma të vogla, nuk janë bërë me qëllim fshehjen e pasurisë apo me qëllim deklarimin në mënyrë të pasaktë të të dhënave për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive. Për këtë shkak, në proporcion me të gjitha rrethanat që kanë lidhje me rivlerësimin e pasurisë, si dhe qëndrimin reflektues që mbajti subjekti i rivlerësimit në lidhje me çdo pasaktësi, ato nuk janë konsideruar si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të subjektit nga detyra.

Në rastin konkret, nga hetimi dhe nga analiza e provave të administruara nuk rezultoi që pasaktësitë në deklaratimet periodike vjetore të kenë pasur për qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo tregimin jo saktë të të dhënave, me qëllim për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve dhe të krijimit të pasurive.

Për këtë arsye, Komisioni çmon se nuk jemi në kushtet e zbatimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në analizë të gjetjeve, trupi gjykues çmon gjithashtu se nuk jemi as para zbatimit të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pra, të cenimit të besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit.

Cenimi i besimit të publikut nga ana e magjistratit është i lidhur ngushtë me faktin se ky i fundit duhet të bëjë një shkelje ligjore gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij. Në rastin konkret është shumë e rëndësishme të arsyetohet se cila do të ishte masa e kësaj shkeljeje dhe se sa një shkelje e caktuar mund të cenoje besimin e publikut për të legjitimuar marrjen e një vendimi në respektim të parimit të proporcionalitetit.

Komisioni çmon se marrja e një mase disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit është në përputhje me qëllimin e ligjit për rivlerësimin. Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me faktin se si duhet të jetë sjellja e një gjyqtari gjatë ushtrimit dhe jashtë ushtrimit të detyrës, në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Në pikat 41 dhe 22.15 të vendimit nr. 28/2019, përcaktohet se: “[...] trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit, zbatimin i të cilit është detyra parësore e një gjyqtari, nëpërmjet vendimeve të dhëna, por jo vetëm. Sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe

autoriteti i pushtetit gjyqësor, është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare që udhëzojnë shembujt më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Më konkretisht, Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, në rregullin 15 përcakton: ‘Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore’. Në komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore është trajtuar gjerësisht sjellja e gjyqtarëve në veprimtarinë jashtëgjyqësore duke e lidhur me elemente të dinjitetit, integritetit, paanësisë dhe reputacionit, ndër të tjera. Për sa i përket sjelljes së gjyqtarëve, në komentari shtjellohet, ndër të tjera: Paragrafi 108 – Kërkoet respektimi i rreptë i ligjit – Shkelja e ligjit nga një gjyqtar mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si gjyqtar, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit [...]. Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitet dhe dëmtojë imazhin e gjyqtarit dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit.

Paragrafi 109 – Sjellja personale e një gjykatësi ndikon në të gjithë sistemin gjyqësor – Besimi në gjyqësor bazohet jo vetëm në kompetencën dhe zellin e anëtarëve të tij, por edhe mbi integritetin dhe drejtësinë e tyre morale. Gjykatësi jo vetëm që duhet të jetë një ‘gjyqtar i mirë’, por edhe një ‘person i mirë’, edhe nëse pikëpamjet për çfarë nënkupton ky koncept mund të ndryshojnë në qarqe të ndryshme të shoqërisë. Nga këndvështrimi i publikut, një gjykatës jo vetëm që është zotuar t’u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të vërtetës mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t’i mishërojë ato. Në përputhje me rrethanat, cilësitë personale, sjellja dhe imazhi që projekton gjyqtari ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe vetëbesimin që publiku vendos në të. Kërkesat e publikut ndaj gjyqtarëve janë shumë më të larta sesa kërkoet nga bashkëqytetarët, standarde të sjelljes që janë shumë më të larta se ato të kërkuara të shoqërisë në tërësi. Në fakt, publiku pret një sjellje pothuajse të paqortueshme nga një gjykatës. Është sikur funksioni gjyqësor, që është gjykimi i të tjerëve, ka imponuar një kërkesë që gjyqtari të mbetet përtej gjykimit të arsyeshëm të të tjerëve në çështje që mund të cenojnë në çfarëdolloj mënyre rolin gjyqësor dhe gjykatën [...].

[...] Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një gjyqtar, i cili edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji. Ky përfundim i trupit gjykues gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Konkretisht, në çështjen e regjistruar në Kolegj me nr. 31/2018 (JR), trupi gjykues, në vlerësimin e tij [në paragrafët nr. 29 dhe 34] për fiktivitet lidhur me çmimin e vendosur nga palët në funksion të përfitimit të një kredie, dhe lidhur me përfitimin e një prone [në paragrafin nr. 50] në kushtet kur nuk përmbusheshin kriteret e vendosura nga një akt nënligjor (VKM), ka konstatuar shkaqe në të cilat gjen zbatim neni 61, pika 5, pasi subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia për shkak të kontratave fiktive për të përfutuar kredi bankare, dhe për shkak të përfitimit të një pasurie në kushtet kur subjekti nuk përmbushte kriteret ligjore për përfitim [...].”

Në rastin konkret, pasaktësitë e konstatuara në DIPP të deklarimit të likuiditeteve cash, si dhe ekzistenca e një balance të vogël në analizën financiare të subjektit gjatë periudhës së rivlerësimit, përbëjnë arsye të cilat nuk mund të konsiderohen si mënyrë sjelljeje e subjektit në kundërshtim me ligjin, që ka pasur si qëllim përfitimin e një të drejtë në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi. E njëjta logjikë vlen dhe duhet të përdoret në konkluzionin se diferencat në vlerë negative të vogël pas analizës financiare të subjektit nuk cenojnë aspak burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

## ANALIZA FINANCIARE E VITEVE 2003 – 2016

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>353 613</b>	<b>493 200</b>	<b>764 792</b>	<b>860 945</b>	<b>767 361</b>	<b>-37 601</b>	<b>1 210 170</b>	<b>3 743 173</b>	<b>236 290</b>	<b>-194 568</b>	<b>195 296</b>	<b>-820 947</b>	<b>9 928</b>	<b>456 230</b>
Apartament banimi 2+1 në adresën, Rr.“D** B**” Pall. *, Apart. *, T**. Vlera e apartamentit 1,245,128 lekë, e shlyer plotësisht deri në vitin 2005.	353 613	43 200	345 500											
Apartamenti me sipërfaqe 53 m2, në C**, K**, të ndërtuar nga Shoaq. “E****” shpk. Vlera e apartamentit 30,000 euro, shlyer plotësisht, sipas deklaratës noteriale nr. rep. 2582, të datës 11.5.2010.								4 164 300						
Autoveturë tipi R** M**, me targa TR** viti i prodhimit 1996 blerë në vitin 2006. Vlera 540,000 lekë.				540 000										
Dhënë hua kumatit të tij A. Sh. nga subjekti, pas emigrimit në U**.							1 500 000							
Shtesa/pakësime likuidite në bankë	0	450 000	419 292	320 945	767 361	-37 601	-289 830	-421 127	236 290	-194 568	195 296	-820 947	9 928	456 230
<i>Gjendje kursimesh (cash) sipas deklarimeve vjetore</i>		450 000	850 000	850 000	850 000	1 150 000	850 000	450 000	650 000	450 000	550 000	0	0	450 000
<i>Total likuidite</i>	0	450 000	869 292	1 190 237	1 957 598	1 919 997	1 630 167	1 209 040	1 445 329	1 250 761	1 446 057	625 111	635 039	1 091 269
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1 888 138</b>	<b>-357 841</b>	<b>-365 060</b>	<b>-442 938</b>	<b>-484 506</b>	<b>289 112</b>	<b>0</b>
Kredi e marrë në 28.05.2010 në vlerë 15,000 euro pranë C** B**.								1 888 138	-357 841	-365 060	-442 938	-484 506	-210 888	
Hua e marrë nga vëllai S.J. dhe nipi M.J. si mbështetje e studimeve shlyer në datë 05.03.2019													500 000	
<b>PASURI NETO</b>	<b>353 613</b>	<b>493 200</b>	<b>764 792</b>	<b>860 945</b>	<b>767 361</b>	<b>-37 601</b>	<b>1 210 170</b>	<b>1 855 035</b>	<b>594 131</b>	<b>170 492</b>	<b>638 234</b>	<b>-336 441</b>	<b>-279 184</b>	<b>456 230</b>
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>1 301 704</b>	<b>1 530 000</b>	<b>2 200 000</b>	<b>2 224 230</b>	<b>2 292 375</b>	<b>2 661 653</b>	<b>2 549 709</b>	<b>2 751 934</b>	<b>2 408 863</b>	<b>1 725 834</b>	<b>1 899 687</b>	<b>1 902 489</b>	<b>1 654 624</b>	<b>1 645 003</b>
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	1 301 704	1 530 000	1 600 000	1 574 230	1 642 375	1 807 320	1 858 363	2 001 934	1 862 367	1 832 834	1 701 263	1 626 028	1 628 372	1 608 408
Të ardhura ofrimi i shërbimit të avokatisë i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit			600 000	650 000	650 000	830 000	621 232	750 000	450 000	-107 000	81 413	245 942	13 724	16 177
Të ardhura nga interesat bankare						24 333	70 114		96 496		117 011	30 519	12 528	20 418
<b>SHPENZIME</b>	<b>636 712</b>	<b>375 856</b>	<b>470 228</b>	<b>510 228</b>	<b>632 776</b>	<b>828 010</b>	<b>699 635</b>	<b>821 159</b>	<b>861 912</b>	<b>835 564</b>	<b>814 199</b>	<b>2 396 975</b>	<b>2 453 653</b>	<b>1 685 000</b>
Pagesat për shlyerjen e interesit të kredisë të marrë pranë C** B**								112 454	174 663	130 844	82 222	41 964	4 508	
Shpenzime për mësimin e gjuhës gjermane të vajzës E.J.												350 275		
Shpenzime për vazhdimin e shkollës për vajzën E.J.												1 120 880	1 376 500	676 350
Shpenzime të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore													150 000	
Shpenzime për shkollimin e djalit në shkollë jo-publike			32 000	72 000	72 000	72 000	40 000							12 500
Shpenzime mjekësore për subjektin të kryera në A***	260 856					110 864								
Shpenzime jetike	375 856	375 856	438 228	438 228	546 480	546 480	652 782	683 100	683 100	697 740	634 608	879 992	874 984	940 368
Shpenzime jetike të vajzës gjatë qëndrimit në Sht***											4 250	3 864	4 301	7 085
Shpenzime udhëtimi					14 296	98 666	6 853	25 605	4 149	6 980	93 119	-	43 360	48 697
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>311 379</b>	<b>660 944</b>	<b>964 980</b>	<b>853 057</b>	<b>892 238</b>	<b>1 871 244</b>	<b>639 903</b>	<b>75 740</b>	<b>952 821</b>	<b>719 778</b>	<b>447 254</b>	<b>-158 045</b>	<b>-519 845</b>	<b>-496 227</b>

## **Konkluzione përfundimtare për kriterin e pasurisë**

Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij.
- iii. Pasaktësia e konstatuar në deklarin më sipër, si dhe masa e konstatuar në mungesën e burimeve të ligjshme, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë në Komision raportin nr. \*\*\*prot., datë 27.10.2017, me të cilin është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, z. Isa Jata.

2. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, DSIK-ja ka i komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht në datën 5.2.2021, me vendim nr. \*\*\*, të KDZH-së.

3. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar fakte të reja lidhur me këtë kriter. Për rrjedhojë, në vijim të hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara nga nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në dokumentet e administruara, në vlerësim të kriterit të kontrollit të figurës në tërësi, Komisioni arrin në përfundimin se për sa kohë nuk janë gjetur fakte apo rrethana që mund të çonin në konkluzionin të ndryshëm nga ai i arritur nga DSIK-ja, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar i përshtatshëm për vijimin e detyrës.

4. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni kreu hetimin administrativ pranë organeve verifikuese dhe kërkoi informacion të përditësuar për subjektin e rivlerësimit.

5. Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë pranë Komisionit informacionin e ardhur prej saj dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, nga ku ka rezultuar se pas verifikimit të kryer në regjistrat e çështjeve penale, referuar të dhënave të transmetuara, në emër të subjektit të rivlerësimit nuk është regjistruar apo mosfilluar procedim penal.

6. Komisioni iu drejtuar me shkresë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila<sup>61</sup> informon se për subjektin e rivlerësimit, pas verifikimit të veprave penale nuk është regjistruar procedim dhe kallëzim penal në ngarkim të tij.

7. Për rrjedhojë, në vijim të komunikimeve me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë kriter, që mund të ngrinin dyshime mbi bazueshmërinë e konkluzioneve të arritura nga DSIK-ja, si më lart. Për rrjedhojë, Komisioni e vlerëson të përshtatshëm subjektin Isa Jata për të vijuar detyrën e prokurorit.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

8. Në zbatim të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. Isa Jata, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale, dorëzuar në Komision me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 21.5.2021, i kryer nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin nr. 159, datë 18.5.2021, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi”, ka miratuar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit Isa Jata, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **1. Aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

<sup>61</sup>Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 20.5.2020, SPAK.

Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi shumë të mira, në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale. Ai shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të normave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2015 dhe 2016, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, si dhe faktet që janë konstatuar nga kontrolli në cilësinë e prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje të praktikave përkatëse.

### **2. Aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës si prokuror, subjekti ka trajtuar 1950 çështje. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 5.6.2020, në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit tregon vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, kryen veprime procedurale hetimore, të cilat rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe duke konkluduar në vendimmarrje.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave nuk konstatohen të dhëna për etikën në punë të prokurorit Isa Jata. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për prokurorin, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor. Rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga subjekti të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

#### *b) Integriteti*



Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia*

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

#### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

*a) Aftësitë e komunikimit*

Nga 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, ka rezultuar se:

- për vitin 2015 – subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit;
- për vitin 2016 – subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

*c) Gatishmëria për t’u angazhuar*

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti i i rivlerësimit rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, si dhe rezulton të ketë marrë pjesë në disa aktivitete profesionale.

### **C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI**

**9.** Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short si edhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pas verifikimit të raportit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

### **VLERËSIMI I DENONCIMEVE DHE VENDIMEVE TË PARAQITURA NË ANKESAT E SUBJEKTEVE DENONCUESE**

**10.** Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku 3 denoncime, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse dhe janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Isa Jata, si vijon:

- denoncimi nr. \*\*\*, datë 13.1.2021, i shtetasit K. M.;
- denoncimi nr. \*\*\*, datë 23.12.2019, i shtetas L. P.;
- denoncimi nr. \*\*\*, datë 26.7.2019, i shtetas S. D.

Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituaram nga verifikimet e të cilëve kreu hetime shtesë dhe i kërkoi subjektit shpjegime për njërin prej tyre.

**10.1** Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\*, datë 13.1.2021, të shtetasit K. M., për ngjarjen e ndodhur në datën 25.10.2017, ku nipi i denoncuesit E. M., i datëlindjes 14.3.2012, ka ndërruar jetë si pasojë e një aksidenti rrugor të ndodhur në K., Tiranë. Denoncuesi ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer riekspertim teknik dy muaj me vonesë, ndërkohë që provat në vendngjarje ishin prishur, si dhe pretendohet se subjekti i ka ushtruar presion psikologjik prindit të viktimës, duke fshehur pamjet filmike të kamerave në vendngjarje. Komisioni, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti për të shqyrtuar me objektivitet pretendimet në denoncim, iu drejtuar me shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,<sup>62</sup> e cila ka përcjellë aktet e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017. Referuar akteve të këtij procedimi rezultoi se të dhënat, shpjegimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit përputhen me dokumentacionin dhe aktet e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 27.10.2020, përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit për ngjarjen e datës 25.10.2017.

**10.2** Pas shqyrtimit të akteve të procedimit penal rezultoi se veprimet hetimore ishin kryer nga subjekti në harkun kohor prej datës 27.10.2017 deri më 9.1.2018. Referuar këtyre akteve, Komisioni konstatoi se hetimet për procedimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2017, në ngarkim të shtetasit Sh. D., nuk ishin përfunduar nga subjekti i rivlerësimit, por nga një subjekt tjetër.

Gjithashtu, u konstatua se disa veprime hetimore si, marrja e kamerave nga subjektet tregtare rreth vendngjarjes dhe pyetja e personave që shoqëronin viktimën, nuk ishin kryer.

Lidhur me konstatimet sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, i cili ka depozituar parashtrimet dhe bashkëlidhur aktet e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017.

Subjekti ka paraqitur në parashtrime ecurinë e procedimit nr. \*\*\*, të vitit 2017, sipas kronologjisë kohore të kryerjes së disa veprimeve hetimore, duke i bashkëlidhur dokumentacionin provues shpjegimeve<sup>63</sup>, nga të cilat rezulton se:

- Në datën 28.10.2017<sup>64</sup> ka përpiluar urdhër për kryerje të veprimeve hetimore, ku është orientuar kryerja e veprimeve hetimore me qëllimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, ku ka kërkuar marrjen e deklaramentit të shtetasve L. M. dhe A. G. .
- Për sa i përket gjetjes dhe administrimit të kamerave të sigurisë, i është kërkuar policisë gjyqësore për kërkesat që kishte bërë me iniciativë pranë Komisarariatit të Policisë nr. 6, Tiranë, dhe pasi të merret përgjigje, “Në varësi të kësaj përgjigjeje të administrohen kamerat e sigurisë për datën dhe orën e ndodhjes së aksidentit ose të kërkohet edhe pranë Bashkisë Tiranë, për të siguruar të dhëna nëse ka subjekte të ndryshme që janë pajisur me kamera sigurie në këtë segment rrugor për të mundësuar të sigurohen pamje filmike të vendit të aksidentit”.

**10.3** Nga aktet e procedimit penal rezulton se në datën 9.1.2018 oficeri i policisë gjyqësore, pasi ka vlerësuar të kryera disa nga veprimet e deleguara, ka përpiluar relacionin për përfundimin e tyre dhe

<sup>62</sup>Shkresë nr. \*\*\*/prot., datë 25.1.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. \*\*\*/ prot., datë 29.1.2021.

<sup>63</sup>Urdhri nr. \*\*\*, datë 9.1.2018, i Prokurorit të Përgjithshëm; vendim nr. \*\*\*, datë 21.1.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për caktimin në pozicion të përkohshëm”; shkurtim i vendimit nr. \*\*\*, datë 22.4.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për caktimin në pozicion të përkohshëm”; shkurtim i vendimit nr. \*\*\*, datë 22.7.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për caktimin në pozicion të përkohshëm”; shkurtim i vendimit nr. \*\*\*, datë 25.10.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për caktimin në pozicion të përkohshëm”; shkurtim i vendimit nr. \*\*\*, datë 12.12.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për ndërprerjen e caktimit të përkohshëm”; aktet e njësuara me origjinalin të fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017, sipas numërimit të bërë nga prokuroria, si dhe shkresën për kërkim dhe vënien në dispozicion të akteve të këtij procedimi.

<sup>64</sup> Faqe 81-83 dhe 157-159 të akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017.

me shkresën nr\*\*\* prot., datë 9.1.2018<sup>65</sup>, janë përcjellë në prokurori, duke sugjeruar edhe për mënyrën e përfundimit.

**10.4** Rezultoi gjithashtu se nga kjo datë e në vijim, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi objektive të njihej me veprimet e kryera më tej nga policia gjyqësore, si dhe aktet e administruara në fashikull apo për të vlerësuar më tej për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, pasi me urdhrin nr. \*\*\*, datë 9.1.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, rezultoi se është komanduar për ushtrim të detyrës pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

**10.5** Ky urdhër është cituar në formularin për trajtimin e procedimit penal nr\*\*\*, të vitit 2017<sup>66</sup>, si dhe në vendimin për zëvendësimin e prokurorit, datë 16.1.2018<sup>67</sup>.

**10.6** Duke analizuar në tërësi veprimet hetimore të kryera për procedimin penal nr. \*\*\*, datë 27.10.2018, trupi gjykues çmoi se nga tërësia e veprimeve procedurale nuk konstatohen veprime dhe mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë çuar në zvarritjen e pajustificuar të veprimeve hetimore, si dhe moskryerje të veprimeve hetimore lidhur me ngjarjen. Denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të subjektit.

**10.7** Në asnjë rast, subjekti i rivlerësimit nuk është bërë shkak me veprimet apo mosveprimet e tij për tejkalimet e afateve të gjykimit dhe nuk u vërtetua që këto tejkalime të kenë qenë të qëllimshme, por ato kanë ardhur për shkaqe të pavarura prej tij, si dhe për shkak të kompleksitetit të çështjeve, rrethanë e cila vlerësohet proporcionalisht në raport edhe me treguesit e tjerë brenda kriterit të aftësive organizative, sikurse ngarkesa në punë.

**10.8** Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

**10.9** Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

**10.10** Në këto kushte, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shyqruara më herët nga KLP-ja, si dhe me denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, ka arritur një nivel kualifikues me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

**10.11** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në analizë të të gjitha denoncimeve, Komisioni konstatoi se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e denoncuara, për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

Nga vlerësimi tërësor i aftësive profesionale u konstatua se mangësitë e evidentuara nuk janë të tilla që të cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit apo që të kenë cenuar të drejtat e palëve në proces, në kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhim, Komisioni çmoi që subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë,

<sup>65</sup> Faqe 146-147 të akteve të procedimit penal nr\*\*\*, të vitit 2017.

<sup>66</sup> Faqe 13 të akteve të procedimit penal nr\*\*\*, të vitit 2017.

<sup>67</sup> Faqe 12 të akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017.

duke respektuar të drejtat e palëve dhe ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme, dhe për këtë arsye është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

### **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Isa Jata, ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Isa Jata, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
    - a. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
    - b. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
    - c. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 15.7.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta Tafa (Bungo)**  
**Kryesuese**

**Lulzim Hamitaj**  
**Anëtar**

**Alma Faskaj**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*

